Msc. Mirjeta Nura Dragusha

# LIBËR PËR MËSUESIN/EN
# BIOLOGJIA 7

Për klasën e 7-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME

pegi

Prishtinë, 2024

Lejohet për botim teksti shkollor për klasën e shtatë, me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nr. xxxx, të datës xxxxxx

**BOTIME**

pegi

Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: xxxx
Korrektore letrare: Ornela LECI
Paraqitja grafike: Ilmi SHAHU
Kopertina: Florinda ZONJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-843-53-9

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, gusht 2024
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

**Botime Pegi:** cel: +355 069 40 075 02;
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
**Sektori i shpërndarjes: cel:** +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
**e-mail:** marketing@botimepegi.al
**Shtypshkronja Pegi**: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

| Lëndët e fushës kurrikulare | TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE | | | | Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës |
|---|---|---|---|---|---|
| | Gjysmëvjetori i parë | | Gjysmëvjetori i dytë | | |
| | **Shtator-tetor**<br>**17 orë** | **Nëntor-dhjetor**<br>**17 orë** | **Janar-shkurt-mars**<br>**22 orë** | **Prill-maj-qershor**<br>**18 orë** | |
| **Lënda: Biologji** | Sistemet e organeve të njeriut: (lëkura, sistemi i organeve për lëvizje (skeleti, muskujt), sistemi i tretjes) | Sistemet e organeve të njeriut (Sistemi i qarkullimit të gjakut, sistemi i frymëmarrjes) | Sistemet e organeve të njeriut (Sistemi i tajitje sistemi nervor, organet shqisore, sistemi endokrin).<br><br>Shumimi te njeriu | Shumimi te njeriu<br><br>Shëndeti sjellja dhe emocionet e njeriut<br><br>Shumimi te shtazët<br><br>Shumimi te bimët | I. Komunikues efektiv<br>I.1; I.2; I.3; I.4; I.5; I.6<br>II. Mendimtar kreativ dhe kritik<br>II.1; II.3; II.4; II.5; II.6; II.7<br>III. Nxënës i suksesshëm<br>III.2; III.3; III.5; III.7; III.8<br>IV. Kontribuues produktiv<br>IV.7; IV.8<br>V. Individ i shëndoshë<br>V.2; V.3; V.5; V.7; V.8; V.9<br>VI. Qytetar i përgjegjshëm<br>VI.1; VI8 |

# PLANI DYMUJOR
# SHTATOR-TETOR

**Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës  Lënda mësimore:  BIOLOGJI  Klasa: VII**

**Tema mësimore:** Sistemi i organeve të njeriut: lëkura, sistemi i organeve për lëvizje (skeleti, muskujt, sistemi i tretjes)

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

**I. Komunikues efektiv**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I.3 Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si: libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si reference gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

I.5 Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**II Mendimtar kreativ dhe kritik**

II.1 Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.

II.3 Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre, duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5. Përzgjedh dhe demonstron ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

**III. Nxënës i suksesshëm**

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

III.7 I parashtron pyetje vetes (Pse?, Çfarë?, Si?, Kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

III.8 Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

**V. Individ i shëndoshë**

V.5 Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësor të njeriut.

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sistemet e organeve të njeriut: (lëkura, sistemi i organeve për lëvizje (skeleti, muskujt), sistemi i tretjes). | Definon termat: qelizë, ind, organ dhe sistem i organeve.<br><br>Përshkruan ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e lëkurës.<br><br>Identifikon prodhimet e lëkurës.<br><br>Hulumton llojet e lëndimeve të lëkurës dhe masat mbrojtëse.<br><br>Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit skeletor. | 1- Njoftimi i nxënësve me plan-programin mësimor<br><br>2- Organizimi hierarkik i organizmit<br><br>3- Lëkura<br>4- Funksionet e lëkurës<br><br>5- Dëmtimet e lëkurës dhe masat për mbrojtjen e saj<br><br>6- Aktivitet (ushtrime)<br><br>7- Ndërtimi i sistemit skeletor<br><br>8- Ndërtimi i kockës dhe nyjat<br><br>9- Ndërtimi i sistemit muskulor | **1 orë**<br><br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br>**1 orë** | Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);<br><br>• Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);<br><br>• Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);<br><br>• Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); | **Aktiviteti në klasë**<br><br>**Vlerësim i vazhdueshëm**<br><br>**Vlerësim me** | Gjuhë dhe komunikimi<br><br>Anatominë<br><br>Fiziologjinë<br><br>Fizikë<br><br>Kimi<br><br>Shëndeti dhe mirëqenia<br><br>TIK<br><br>Edukimi për media<br><br>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm etj. | Biologjia 7<br>Fletore e punës<br>Atlasi i anatomisë<br>Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.<br>Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, video-projektori, ,kompjuteri, interneti, etj. |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit muskulor.<br><br>Identifikon, lëndimet si dhe masat mbrojtëse të sistemit për lëvizje.<br><br>Përshkruan procesin dhe rrugën e tretjes së ushqimit të njeriut.<br><br>Vlerëson rolin e organeve të veçanta në procesin e tretjes.<br><br>Vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së sistemit të organeve të tretje | 10- Dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit skeletor dhe atij muskulor<br><br>11-Punë praktike (hulumtojnë kripërat minerale dhe lëndët protonike në kocka)<br><br>12- Tretja dhe pjesët e aparatit tretës<br><br>13- Përthithja e ushqimit në zorrë<br><br>14- Roli i mëlçisë dhe i pankreasit në procesin e tretjes<br>15- Ushtrime<br><br>16- Problemet e sistemit tretës dhe masat për mbrojtjen e tij<br><br>17- Test vlerësues (lëkura, sistemi i lëvizjes, sistemi i organeve të tretjes) | **1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë** | • Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;<br><br>• Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;<br><br>• Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;<br>• Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;<br><br>Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur | **gojë(diskutime, debate)**<br><br>**Vlerësim diagnostifikues**<br><br>**Vlerësim i bazuar në kriter**<br><br>**Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte**<br><br>**Vlerësim me shkrim (testeve, eseve)** | | |

# PLANI DYMUJOR
# NËNTOR-DHJETOR

**Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës** **Lënda mësimore: BIOLOGJI** **Klasa: VII**

**Tema mësimore:** Sistemi i qarkullimit të gjakut, sistemi i frymëmarrjes

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

**I. Komunikues efektiv**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I.3 Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si: libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si reference gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

I.5 Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të rinj, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**II Mendimtar kreativ dhe kritik**

II.1 Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.

II.3 Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5. Përzgjedh dhe demonstron ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

**III. Nxënës i suksesshëm**

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

III.7 I parashtron pyetje vetes (Pse?, Çfarë?, Si?, Kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

III.8 Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

**V. Individ i shëndoshë**

V.5 Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësor të njeriut.

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sistemi i qarkullimit të gjakut<br><br>Sistemi i frymëmarrjes | Hulumton përbërjen, rolin dhe rëndësinë e përbërësve të gjakut dhe limfës.<br>Analizon ndërtimin dhe punën e zemrës.<br>Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit të qarkullimit të gjakut.<br>Sqaron konceptet: imunitet, alergji dhe identifikon grupet e gjakut. | 18- Elementet përbërëse të gjakut dhe të limfës. Roli i tyre.<br><br>19- Zemra dhe funksionet e saj<br><br>20- Ndërtimi dhe funksionet e sistemit të qarkullimit të gjakut.<br><br>21- Grupet e gjakut.<br><br>22- Sistemi imunitar<br><br>23- Ushtrime (Qarkullimi i gjakut te bretkosa).<br><br>24-25 Projekt (Lëkura, muskujt, sistemi i tretjes, mëlçia dhe pankreasi, sistemi i qarkullimi i gjakut, zemra). | **1 orë**<br><br>**1 orë**<br>**2 orë**<br><br>**1 orë**<br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br><br>**2 orë**<br><br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br><br>**1 orë**<br><br>**2 orë** | Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);<br><br>• Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);<br><br>• Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); | **Aktiviteti në klasë**<br><br>**Vlerësim i vazhdueshëm**<br><br>**Vlerësim me gojë(diskutime, debate)**<br><br>**Vlerësim diagnostifikues**<br><br>**Vlerësim i bazuar në kriter** | Gjuhë dhe komunikimi<br><br>Anatominë<br><br>Fiziologjinë<br><br>Fizikë<br><br>KIMI<br><br>Shëndeti dhe mirëqenia<br><br>TIK<br><br>Edukimi për media<br><br>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm etj. | Biologjia 7<br>Fletore e punës<br>Atlasi i anatomisë<br>Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.<br>Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, video-projektori, ,kompjuteri, interneti, etj. |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emërton rrugët e frymëmarrjes, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre.<br><br>Përshkruan mekanizmat e frymëmarrjes mushkërore dhe rregullimin e saj.<br><br>Vlerëson rolin dhe domosdoshmërinë e ruajtjes së organeve të frymëmarrjes si dhe faktorët që dëmtojnë organet e frymëmarrjes. | 26- Ndërtimi dhe funksioni i rrugëve të Frymëmarrjes.<br><br>27-Ajrimi i mushkërive (rregullimi i ajrit në sistemin mushkëror).<br><br>28- Frymëmarrja qelizore.<br><br>29- Duhani dhe ndikimi i tij në sistemin e Frymëmarrjes.<br><br>30-31 Ushtrime (punë praktike, sistemi i frymëmarrjes, faqe 59).<br><br>32-Test vlerësues<br><br>33- Ushtrime (aktivitete vetëdijesuese kundër përdorimit të duhanit) | **1 orë**<br><br>**1 orë** | • Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);<br>• Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;<br>• Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;<br>• Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;<br>• Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve; multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;<br><br>Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur | **Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte**<br><br>**Vlerësim me shkrim (testeve, eseve)** | | |

# PLANI DYMUJOR
# JANAR-SHKURT-MARS

**Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës** **Lënda mësimore: BIOLOGJI** **Klasa: VII**

**Tema mësimore:** Sistemet e organeve të njeriut (sistemi i tajitjes, sistemi nervor, organet shqisore, sistemi endokrin).
Shumimi te njeriu

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

**I. Komunikues efektiv**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I.3 Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si: libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I. 6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**II. Mendimtar kreativ dhe kritik**

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5. Përzgjedh dhe demonstron ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

II. 6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

**III. Nxënës i suksesshëm**

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

III.7 I parashtron pyetje vetes (Pse?, Çfarë?, Si?, Kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

III.8 Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

**V. Individ i shëndoshë**

V.3 Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.

V.8 Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit.

**VI. Qytetar i përgjegjshëm**

VI.1 Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësor të njeriut.

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sistemet e organeve të njeriut (Sistemi i tajitje sistemi nervor, organet shqisore, sistemi endokrin).<br><br>Shumimi te njeriu | Defino termin tajitje dhe emërton organet kryesore për tajitje te njeriu.<br><br>Analizon krijimin e urinës.<br><br>Hulumton mundësitë e ruajtjes së sistemit të sekretimit.<br><br>Hulumton ndërtimin dhe funksionimin e sistemit nervor.<br><br>Analizon ndërvatësin e pjesëve të sistemit nervor.<br><br>Analizon harkun refleksiv.<br><br>Analizon mundësin për kujdesin ndaj sistemit nervor dhe pasojat në rast dëmtimi. | 35- Tajitja, sistemi i tajitjes te njeriu<br><br>36- Etapat e formimit të urinës<br><br>37- Problemet e sistemit të tajitjes dhe parandalimi i tyre<br><br>38- Ndërtimi i neuroneve dhe llojet e tyre<br><br>39- Ndarja e sistemit nervor<br><br>40- Bashkërendimi midis pjesëve të sistemit nervor<br><br>41- Sinapsi. Harku refleksiv<br><br>42- Dëmtimet e sistemit nervor dhe pasojat e tyre<br><br>43-44 Projekt (Tajitja, ndërtimi i neuroneve, harku refleksiv, organet e tajitjes, dëmtimet dhe pasojat e sistemit nervor, sistemit tajitës) | **1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**2 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë** | Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);<br><br>• Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);<br><br>• Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);<br>• Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); | **Aktiviteti në klasë**<br><br>**Vlerësim i vazhdueshëm**<br><br>**Vlerësim me gojë(diskutime, debate)**<br><br>**Vlerësim diagnostifikues**<br><br>**Vlerësim i bazuar në kriter**<br><br>**Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte** | Gjuhë dhe komunikimi<br><br>Anatominë<br><br>Fiziologjinë<br><br>Fizikë<br><br>KIMI<br><br>Shëndeti dhe mirëqenia<br><br>TIK<br><br>Edukimi për media<br><br>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm etj. | Biologjia 7<br>Fletore e punës<br>Atlasi i anatomisë<br>Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.<br><br>Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, video-projektori, ,kompjuteri, interneti, etj. |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emërton dhe përshkruan organet shqisore në trupin tonë, (shqisa së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore) si dhe analizon funksionin e tyre.<br><br>Identifikon dëmtimet dhe masat mbrojtëse të shqisave.<br><br>Emërton gjëndrat me tajitje të brendshme te njeriu dhe përshkruan pozitën e tyre në trup.<br><br>Përshkruan si gjëndrat endokrine kontrollojnë organe e funksionet të caktuara nëpërmjet hormoneve. | 45- Organet shqisore: të parit dhe të dëgjuarit<br><br>46- Organet e tjera shqisore<br><br>47- Dëmtimet e shqisave dhe masat për mbrojtjen e tyre<br><br>48- Punë praktike (mprehtësia e të parit, dëgjuarit)<br><br>49-Punë praktike (receptorët ndijor faqe 81)<br><br>50-Gjëndrat me tajitje të brendshme<br><br>51-Kontrolli i funksioneve të organeve nga gjëndrat endokrine | **1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë** | • Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;<br>• Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;<br>• Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;<br>• Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; | **Vlerësim me shkrim (testeve, eseve)** | | |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Përshkruan ndërtimi dhe funksionin e gjëndrave seksuale te njeriu.<br>Tregon se sistemi Riprodhues seksual, lehtëson procesin e trashëgimisë (bartjen e informatave gjenetike ose tipareve gjenetike nga një gjeneratë në tjetrën.<br><br>Përshkruan shkurtimisht strukturat e sistemeve riprodhuese të individit femër dhe mashkull si dhe funksionin e tyre në frytëzim.<br>Përshkruan ndryshimet e trupit gjatë rritjes zhvillimit dhe ndikimin e reflektimeve të të tjerëve për shëndetin e tyre | 52- Ushtrime (faqe 87)<br>53- Test vlerësues<br>54- Qelizat e riprodhimit te mashkulli dhe te femra<br><br>55-Trashëgimia gjenetike në bazë të sistemit të riprodhimit seksual<br><br>56-Strukturat riprodhuese mashkullore dhe ato femërore | | Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur. | | | |

# PLANI DYMUJOR
# PRILL-MAJ-QERSHOR

**Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës** **Lënda mësimore: BIOLOGJI** **Klasa: VII**

**Tema mësimore:** Shumimi te njeriu, Shëndeti sjellja dhe emocionet e njeriut, Shumimi te shtazët Shumimi te bimët

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

**I. Komunikues efektiv**

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

I. 6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të rinj, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**II. Mendimtar kreativ dhe kritik**

II. 6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

**III. Nxënës i suksesshëm**

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

III.7 I parashtron pyetje vetes (Pse?, Çfarë?, Si?, Kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

III.8 Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

**IV. Kontribuues produktiv**

IV.7 Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve

kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shumimi te njeriu<br><br>Shëndeti sjellja dhe emocionet e njeriut<br><br>Shumimi tek shtazët<br><br>Shumimi tek bimët | Identifikon shërbimet ku adoleshentët mund të shkojnë për ndihmë.<br><br>Identifikon përgjegjësitë e prindësisë së hershme, rritjes së fëmijëve, planifikimit familjar, planifikimit në karrierë, kontracepsionin, vendimmarrjen dhe kujdesin në rast të shtatzënisë<br><br>Përshkruan sjelljet e rrezikshme, simptomat përcjelljen dhe parandalimin e STS dhe HIV | 57- Ndryshimet trupore në pubertet<br><br>58- Aktivitet vlerësues<br><br>59- Adoleshenca dhe problemet e saj<br><br>60-61- Informimi, edukimi dhe këshillimi mbi shëndetin riprodhues<br><br>62-Sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe HIV-i<br>63- Ushtrime (faqe 104, 105)<br>64- Cikli jetësor te gjallesat<br>Shtazore | **1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**2 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**2 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë**<br>**1 orë** | Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);<br>• Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);<br>• Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);<br>• Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); | **Aktiviteti në klasë**<br><br>**Vlerësim i vazhdueshëm**<br><br>**Vlerësim me gojë(diskutime, debate)**<br><br>**Vlerësim diagnostifikues**<br><br>**Vlerësim i bazuar në kriter**<br><br>**Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte** | Gjuhë dhe komunikimi<br>Anatominë<br>Fiziologjinë<br>Fizikë<br>KIMI<br>Shëndeti dhe mirëqenia<br>TIK<br>Edukimi për media<br>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm etj. | Biologjia 7<br>Fletore e punës<br>Atlasi i anatomisë<br>Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.<br>Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, video-projektori, ,kompjuteri, interneti, etj. |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shpjegon të drejtat seksuale për vete, të tjerët ligji dhe rregulloret..<br><br>Vlerëson ndikimin e moshës, gjinisë, religjionin dhe kulturës në marrëdhënie.<br><br>Zbaton fjalët dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli jetësor.<br><br>Hulumton dhe të përshkruan format e shumimit te shtazët.<br><br>Hulumton dhe përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të shumimit tek organizmat e ndryshëm. | 65-66- Format e shumimit te kafshët dhe Aspektet nga jeta e organizmave të ndryshëm shtazorë<br><br>67- Fazat e zhvillimit të ujëtokësorëve dhe të shpendëve<br><br>68- Roli i shumimit të kafshëve në botën e gjallë<br><br>69- Projekt (syri, veshi, sistemi endokrin, sistemi riprodhues, shumimi te shtazët) | **1 orë**<br><br>**1 orë** | • Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;<br><br>• Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;<br><br>• Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;<br>• Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; | **Vlerësim me shkrim (testeve, eseve)** | | |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet mjetet dhe materialet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Hulumton fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës.<br><br>Vlerëson rolin e shumimit<br>të shtazëve në zhvillimin e<br>botës së gjallë.<br>Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te bimët.<br><br>Hulumton dhe përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të shumimit te grupet bimore.<br><br>Vlerëson rolin e shumimit të bimëve në zhvillimin e botës<br>së gjallë. | 70- Test vlerësues<br><br>71- Format e shumimit te bimët<br><br>72- Procesi i shumimit te grupet e ndryshme bimore<br><br>73- Roli i shumimit të bimëve në botën e gjallë<br><br>74-Punë praktike(shumimi vegjetativ përmes rrënjëzimit<br>të gjetheve të begonjës). | | Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur | | | |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Sistemet e organeve të njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- përkufizon termat: qelizë, ind, organ dhe sistem i organeve. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; I.2; II.3; II.6; III.8 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** 1.1 Organizimi hierarkik i organizmit | | | |
| **Fjalët kyçe:** qelizë, ind epitelial, ind muskulor, ind nervor, organe, aparat, sistem, organizëm. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>- përshkruan qelizat, indet, organet, aparatet, sistemet dhe organizmin që ka para vetes me vetitë, duke i kategorizuar ato sipas një radhitjeje hierarkike përkatëse;<br>- interpreton disa karakteristika të niveleve hierarkike të një organizmi;<br>- radhit saktë pjesët ndërtuese të organizmit tonë sipas radhitjes hierarkike që i përkasin në trenin e formuar.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- trego, së paku një ose dy arsye të radhitjes hierarkike të pjesëve ndërtuese të organizmit tonë;<br>- shqyrto nivelet hierarkike të organizimit të një organizmi me së paku një shembull;<br>- rendit duke arsyetuar pjesët ndërtuese të organizmit tonë në radhitje hierarkike në qelizë, inde, organe, aparate, sisteme dhe organizëm. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fotografitë e qelizave, indeve, organeve, aparateve, sistemeve dhe organizmit të njeriut. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore**: Gjuhën shqipe, Matematikë, Anatomi, Fiziologji<br>Çështjet ndërkurrikulare**:** Edukim për media | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Pjesa hyrëse:** *Brainstorming*<br>Mësuesi/ja u paraqet nxënësve fotografi ose një model plastik mësimor i trupit të njeriut ku tregohen organet dhe sistemet e organeve të trupit të njeriut. Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të thonë çfarë ata dinë rreth ndërtimit të trupit të njeriut. | | | |

**Pjesa kryesore:** *Ditari dypjesësh*
Mësimdhënësi u shpjegon nxënësve njësinë mësimore dhe i orienton që të lexojnë njësinë mësimore dhe në fletoret e tyre të formojnë një tabelë më dy kolona ku në njërën kolonë shënohen termat: qelizë, ind, organ, sistem organesh, organizëm, kurse në anën tjetër shënohen definicionet e tyre.

| | |
|---|---|
| Qelizë | |
| Ind | |
| Organ | |
| Sistem organesh | |
| Organizëm | |

**Pjesa përfundimtare:**

Mësuesi/ja shkruan në fleta emrat si: qelizë, ind nervor, ind lidhor, veshka, aparati i sekretimit, sistemi i qarkullimit të gjakut, njeriu i gjinisë mashkullore dhe njeriu i gjinisë femërore. Nxënësit i përzgjedhin ato në mënyrë të rastësishme. Emrat duhet të radhiten si vagonët e trenit, sipas radhitjes hierarkike. Në të njëjtën kohë formojmë dyshet në kolonë ku nxënësi/ja i dyshes do të arsyetojë pse shoku/shoqja mban këtë radhë.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin, saktësinë e shqyrtimit dhe definimin e qelizës, indit, organit, aparatit, sistemit dhe organizmit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Rendit nivelet e organizimit të një organizmi sipas hierarkisë së tyre me anë të një skice (skeme).
Vizatoni indet kryesore të trupit të njeriut nga figura – Indet trupore (nga libri Biologjia, faqe 8).

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda: Biologji</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa:<br>VII</td></tr>
<tr><td>Tema: Sistemet e organeve të njeriut</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:<br>- përshkruan ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e lëkurës.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4; II.7; III.5; III.7.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: 1.2 Lëkura</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: lëkura, epiderma, derma hipoderma.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon ç'di për lëkurën, ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e saj;<br>- i parashtron pyetje vetes rreth lëkurës, ndërtimit, rolit dhe rëndësisë së saj;<br>- organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën e dhënë.<br>Kriteret e suksesit:<br>- rendit së paku 3-4 informata rreth lëkurës, ndërtimin, rolin dhe rëndësisë së saj;<br>- formulo së paku dy pyetje të niveleve të ndryshme lidhur me lëkurën, përmbajtjen, përbërjen dhe rëndësinë e saj;<br>- gjenero mendimin tënd në formë të shkruar për pyetjen/temën e dhënë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet: Libri i Biologjisë 7<br>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: modeli i lëkurës, flipchart-i me fotografi të shtresave të lëkurës.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Anatomi, Fiziologji.<br>Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për shëndet</td></tr>
<tr><td colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Pjesa hyrëse:<br>Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve të parashtruara:<br>- Çfarë dini rreth lëkurës si mbështjellëse e trupit të organizmit tuaj?<br>Informacionet e nxënësve shënohen në shtyllën e parë të tabelës së paraqitur.</td></tr>
</table>

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| - Lëkura është mbështjellësja e trupit tonë.<br>- Lëkura ka trashësi të ndryshme në pjesët e ndryshme të trupit p.sh. te syri është më e hollë dhe më e ndjeshme se te shputat e këmbëve që është më e trashë dhe më pak e ndjeshme.<br>- Lëkura ka tri shtresa… | | |

**Pjesa kryesore:**
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të parashtrojnë pyetje se çfarë dëshirojnë të dinë më tepër për ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e lëkurës (plotësohet shtylla e dytë me pyetjet e nxënësve). Mësuesi/ja i paraprin shtrimit të pyetjeve sipas rastit.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| - Lëkura është mbështjellësja e trupit tonë.<br>- Lëkura ka trashësi të ndryshme në pjesët e ndryshme të trupit p.sh. te syri është më e hollë dhe më e ndjeshme se te shputat e këmbëve që është më e trashë dhe më pak e ndjeshme.<br>- Lëkura ka tri shtresa… | - Çfarë përmban epiderma, dhe ku gjendet ajo?<br>- Nga se përbëhet dhe çfarë përmban derma?<br>- Cili është roli i hipodermës…? | |

Nxënësit lexojnë materialin mësimor në heshtje, duke pasur parasysh gjetjen e përgjigjeve në pyetjet e shtruara.

**Pjesa përfundimtare:**
Mësuesi/ja i pyet nxënësit nëse i kanë gjetur përgjigjet në pyetjet e shtruara. Përgjigjet shkruhen në shtyllën e tretë të tabelës.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| - Lëkura është mbështjellësja e trupit tonë.<br>- Lëkura ka trashësi të ndryshme në pjesë të ndryshme të trupit, p.sh. te syri është më e hollë dhe më e ndjeshme se te shputat e këmbëve që është më e trashë dhe më pak e ndjeshme.<br>- Lëkura ka tri shtresa… | - Çfarë përmban epiderma, dhe ku gjendet ajo?<br>- Nga se përbëhet dhe çfarë përmban derma?<br>-Cili është roli i hipodermës…? | - Epiderma përmban proteinë, keratinë, lëndë yndyrore, qelizat e vdekura, melanocitet që përmbajnë melaninë. Është pjesa sipërfaqësore e lëkurës.<br>- Derma përbëhet nga indi lidhor, përmban enë gjaku, rrënjën (folikulat) e qimeve, gjëndrat e djersës, yndyrës si dhe mbaresat nervore, muskujt.<br>- E mbron trupin nga i ftohti, zbut goditjet dhe shërben si rezervë energjetike e organizmit. |

Pyetjeve që nxënësit parashtrojnë dhe nuk u gjejnë dot përgjigjet në tekst, mund t'u përgjigjet mësuesi/ja.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me lëkurën.
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit rreth njohurive që kanë për ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e lëkurës, nivelet e pyetjeve, gjetjen e përgjigjeve.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetjet dhe detyrat në librin e biologjisë, në faqen 11.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- Identifikon prodhimet e lëkurës. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; I.2; I.6; II.5; III.3; III.5 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore**: 1.3 Funksionet e lëkurës | | | |
| **Fjalët kyçe**: gjëndrat yndyrore, gjëndrat djersore, qimet, thonjtë. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>- vrojton prodhimet e lëkurëve, të prezantuara, duke nxjerrë përfundime mbi vendndodhjen (shtresat) ku gjinden ato;<br>- shpjegon ndërtimin dhe rolin e prodhimeve të lëkurës;<br>- kategorizon njohuritë rreth ndërtimit vendndodhjes (shtresat) dhe rolin e prodhimeve të lëkurës.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>- radhit së paku 3-4 prodhime të lëkurës dhe shtresat ku ndodhen ato;<br>- argumento me së paku një shembull nga jeta e përditshme për ndërtimin dhe rolin e prodhimeve të lëkurës;<br>- paraqit njohuritë rreth ndërtimit vendndodhjes (shtresat) dhe rolin e prodhimeve të lëkurës përmes organizuesit grafik. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë 7<br><br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fotografitë ku paraqiten gjëndra yndyrore, gjëndra djersore, qimeve si flokët, qerpikët, vetullat, qimet si mbulesë trupore, thonjtë. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Anatomi, Fiziologji.<br>Çështjet ndërkurrikulare**:** Edukim për media | | | |

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Pjesa hyrëse:**
Mësuesi/ja, në fillim të orës paraqet para nxënësve videon (fotografitë) e gjëndrës yndyrore, gjëndrës djersore, qimeve, si: flokët, qerpikët, vetullat, qimet si mbulesë trupore, thonjtë, dhe kërkon nga nxënësit

| Prodhimet e lëkurës | Shtresat e lëkurës ku i hasim këto prodhime |
|---|---|
| • Gjëndrat yndyrore | • Derma |
| • Qimet | • Derma |
| • Thonjtë | • Epiderma |
| • … | • … |

Më pas, disa nxënës prezantojnë radhitjen e tyre në shtylla. Mësuesi/ja ndërhyn sipas rastit.

**Pjesa kryesore:** Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD)
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që pasi të lexojnë njësinë mësimore, të vëzhgojnë në tekst me kujdes dhe të nxjerrin përfundime.
Pasi nxënësit lexojnë mësimin, mësuesi/ja drejton pyetjet:
1.Cilat shtresa e ndërtojnë lëkuren?
2. Ku janë të vendosura gjëndrat e yndyrës?
3. Ç'është djersa?
4. Cili është funksioni i qimes?
5. Si janë të ndërtuar thonjtë?

**Pjesa përfundimtare:**
Me anë të organizuesve grafikë, nxënësit individualisht, paraqesin prodhimet e lëkurës dhe funksionet e saj. Dy-tre nxënës punimet e tyre prezantojnë para klasës.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë bashkëpunimin në dyshe, radhitjen dhe përgjigjet lidhur me prodhimet e lëkurës dhe rolin e tyre.
Mësuesi/ja vlerëson radhitjen në bazë të vrojtimit, të prodhimeve të lëkurës, mënyrën e shpjegimit në dyshe lidhur me ndërtimin dhe rolin e tyre, si dhe prezantimet e organizuesve grafikë.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumto dhe sill disa kuriozitete lidhur me prodhimet e lëkurës.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | |
|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shkencat e natyrës | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- hulumton llojet e lëndimeve të lëkurës dhe masat mbrojtëse. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; II.4; III.3; III.7 | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | |
| **Njësia mësimore**: 1.4 Dëmtimet e lëkurës dhe masat për mbrojtjen e saj | | |
| **Fjalët kyçe**: aknet, zgjebja, kanceri i lëkurës. | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>- dallon dëmtimet dhe sëmundjet e lëkurës duke i vendosur ato në shtyllat përkatëse të tabelës;<br>- arsyeton shkaktarët për dëmtimet dhe sëmundjet e lëkurës, si dhe këshillat për kujdesin ndaj tyre;<br>- zgjidh fjalët e sakta që lidhen me dëmtimet dhe sëmundjet e lëkurës për plotësimin e fjalëkryqit.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- radhit së paku 2-3 dëmtime dhe sëmundje të lëkurës në shtyllat përkatëse;<br>- plotëso diagramet me së paku 3-4 shkaktarë për dëmtimet dhe sëmundjet e lëkurës, si dhe këshillat për kujdesin ndaj tyre;<br>- gjej së paku 3-4 fjalë të sakta që lidhen me dëmtimet dhe sëmundjet e lëkurës për plotësimin e fjalëkryqit. | | |
| **Burimet:** Libri i biologjisë<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** hamerat e përgatitur për çdo grup, markerat, fjalëkryqet për çdo grup. | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Matematikë, Gjuhë shqipe.<br>Çështjet ndërkurrikulare**:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | |
| **Pjesa hyrëse:**<br>Mësuesi/ja shënon etiketat ne tabelë dhe kërkon nga nxënësit t'i radhitin ato në shtyllat përkatëse. | | |

| Lëndët kimike | Kanceri i lëkurës | Agjentët atmosferikë |
|---|---|---|
| Zgjeba (zhuga) | Mikrobet e ndryshme | Aknet |

Nxënësit duhet t'i radhisin etiketat në tabelën e prezantuar më poshtë

| Dëmtuesit e lëkurës | Sëmundjet e lëkurës |
|---|---|
| • Lëndët kimike | • Kanceri i lëkurës |
| • Agjentët | • Zgjeba |
| • … | • … |

Më pas, disa nxënës prezantojnë radhitjen e tyre në shtylla duke e arsyetuar këtë radhitje. Mësuesi/ja ndërhyn sipas rastit.

**Pjesa kryesore:**

Mësuesi/ja formon 4 grupe me nxënës, secilit grup i caktoj nga një pjesë të materialit mësimor që duhet ta lexojnë, si dhe kohën për lexim.

Grupi 1 - Djegia e lëkurës
Grupi 2 - Aknet
Grupi 3 - Zgjebja
Grupi 4 - Kanceri i lëkurës

Pas leximit, nxënësit e grupeve ndahen në 2 nëngrupe dhe secili nëngrup plotëson diagramet e dhëna:

Gr.1

Shkaktarët që lëkura pëson djegie.
Arsyeton pse lëkura pëson djegiet.

Gr.2

Shkaqet kryesore të formimit të akneve
Arsyeto ç'janë dhe pse

Gr.3

Shkaktarët e zgjebes ku shfaqet ajo
Arsyeto zgjeba

Gr.4

Shkaktarët e kancerit të lëkures.
Arsyeto diagnostifikim i hershëm të s dhe këshillat mbrojtëse.

Pas plotësimit të diagrameve, udhëheqësit e grupeve prezantojnë punën e tyre duke dhënë sqarime lidhur me kërkesat. Mësuesi/ja ndërhyn sipas rastit.

**Pjesa përfundimtare:**

Nxënësit plotësojnë fjalëkryqin duke u bazuar te shprehjet e mëposhtme:

Horizontalisht:
1.Këpusha e zgjebes
2.Shkaktar i djegies së lëkurës
Vertikalisht:
3.Sëmundje që shkaktohet me ekspozimin e gjatë me rreze ultraviolet.
4. Puçrrat e pubertetit
5 . Sëmundje ngjitëse e lëkurës




Mësuesi/ja evidenton saktësinë dhe shpejtësinë e plotësimit të fjalëkryqit në grupe (në formë të garës me kohë të caktuar më parë).

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë bashkëpunimin, radhitjen e etiketave, shpjegimet e dhëna lidhur me dëmtimet dhe sëmundjet e lëkurës, plotësimin e fjalëkryqit.
Mësuesi/ja vlerëson dallimin mes dëmtuesve dhe sëmundjeve të lëkurës shpjegimeve të shkaktarëve të sëmundjeve dhe dëmtimeve të lëkurës, saktësisë dhe kohën e plotësimit të fjalëkryqit.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përgjigjuni pyetjeve rreth njësisë mësimore faqe 15, libri i biologjisë.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës**: III | **Klasa**: VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit skeletor. | | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2; I.6; III.3; III.7; II.6 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore**: 1.5 Ndërtimi i sistemit skeletor | | | |
| **Fjalët kyçe**: skeleti i njeriut: kockat e kokës, kockat e shtyllës kurrizore, kockat e kafazit të kraharorit, kockat e gjymtyrëve të sipërme dhe kockat e gjymtyrëve të poshtme. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>- tregon si lëviz njeriu dhe roli i sistemit skeletor;<br>- përshkruan, ndërtimin dhe funksionin e pjesëve ndërtuese të sistemit skeletor i dal nga hulumtimi i tij;<br>- emërton pjesët e skeletit duke përdorur fjalët në kutinë e fjalëve.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- shpjego së paku 1-2 role të sistemit skeletor në organizmin tone;<br>- veço së paku 3 pjesë ndërtuese të pjesëve kryesore të skeletit dhe funksionin e tyre;<br>- përzgjidh fjalët nga kutia e fjalëve për të emërtuar pjesët e skeletit. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** skeleti i njeriut, fletat me fotografi të skeletit të njeriut dhe kutinë e fjalëve | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Matematikë, Gjuhë shqipe, Anatomi, Fiziologji Çështjet ndërkurrikulare**:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Pjesa hyrëse:** Breinstorming<br>Bashkëbisedim me nxënës për njohuritë paraprake për skeletin dhe rëndësinë e tij në lëvizje.<br>Kërkojmë nga nxënësit që të vrojtojnë modelin e skeletit të njeriut dhe të tregojnë si ndahet skeleti i njeriut. Informacionet e nxënësve, mësuesi/ja i shënon në tabelë. I nënvizojmë ndarjet kryesore, nëse dalin nga ta: kockat e kokës, kockat e shtyllës kurrizore, kockat e kafazit të kraharorit, kockat e gjymtyrëve të sipërme dhe kockat e gjymtyrëve të poshtme. Nxënësit tregojnë se cili mund të jetë funksioni i këtyre pjesëve. | | | |

**Pjesa kryesore:**
Formojmë 5 grupe me nxënës. Secili grup duhet të hulumtojë një pjesë të skeletit dhe të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e kësaj pjese. Këto grupe quhen grupe të familjes.
Grupi 1 hulumton në modelin e skeletit kockat e kokës.
Grupi 2 hulumton në modelin e skeletit kockat e shtyllës kurrizore.
Grupi 3 hulumton në modelin e skeletit kockat e kafazit të kraharorit.
Grupi 4 hulumton në modelin e skeletit kockat e gjymtyrëve të sipërme.
Grupi 5 hulumton në modelin e skeletit kockat e gjymtyrëve të poshtme.
Kërkojmë nga një nxënës vullnetar të çdo grupi që të lexojnë përshkrimet e dala nga hulumtimi i tyre lidhur me ndërtimin dhe funksionin e pjesëve ndërtuese të sistemit skeletorë të njeriut. Në fund, mësuesi/ja jep sqarime shtesë sipas nevojës mbi ndërtimin dhe funksionin e sistemit skeletor të njeriut.

**Pjesa përfundimtare:**
Nxënësve në grupe u shpërndajmë fotografinë e skeletit të njeriut dhe u kërkojmë të emërtojnë kockat ndërtuese të tij duke përdorur fjalët në kutinë e fjalëve.

**Kutia e fjalëve**
Kafka, shtylla kurrizore, kocka e legenit, brinja, radiusi, metakarpet, kockat e fytyrës, kafazi i kraharorit, fallangjet, fibulla, nofulla e poshtme, shputa, tibia,
gishtat, shpatullat, vertebrat.



Në fund, nxënësit shkëmbejnë fletat ku vlerësojnë plotësimin e tyre. Mësuesi/ja evidenton saktësinë dhe shpejtësinë e kryerjes së detyrës së kërkuar.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë dhënies së përgjigjeve në pyetjet e bëra, hulumtimit, emërtimit si dhe bashkëpunimit në grup.
Mësuesi/ja vlerëson njohuritë, përgjigjet e dhëna në pyetjet e parashtruara dhe shpjegimin rreth rolit të skeletit, përshkrimit të ndërtimit dhe funksionit të skeletit, emërtimit të pjesëve të skeletit dhe frymës bashkëpunuese në grupe.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Argumentoni me shembuj funksionet kryesore të sistemit skeletor të njeriut.

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës**: III | **Klasa:** VII |
|---|---|---|---|
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | **Rezultati i të nxënit të temës:** -hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit skeletor. | | |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2; II.6; II.7; III.3; I.5

**Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore**: 1.6 Ndërtimi i kockës dhe nyjat

**Fjalët kyçe**: lidhjet, kyçe e lëvizshme, kyçe pak të lëvizshme.

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**
- paraqet qëndrimet lidhur me pyetjen e shtruar;
- analizon ndërtimin e kockës dhe ndarjen e tyre sipas lidhjeve që ato krijojnë;
- përmbledh njohuritë e fituara për ndërtimin e kockave dhe nyjave me anë të një eseje.

**Kriteret e suksesit:**
- prezanto qëndrimet pro dhe kundër në pyetjen e shtruar;
- shpjego ndërtimin e kockave dhe lidhjeve (nyjave) që ato krijojnë të paraqitura në formë tabelare;
- shkruaj një ese duke iu përmbajtur pikave të planit.

**Burimet:** Libri i Biologjisë, klasa VII
**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** modeli i skeletit të njeriut, fletat me kërkesat të paraqitura në tabelë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Anatomi, Fiziologji.
Çështjet ndërkurrikulare**:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Pjesa hyrëse:**
Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe brenda grupit formon dyshet, të cilat ndahen me qëndrimin "pro" dhe "kundër", shtron pyetjen:
*Si mendoni, a është i njëjtë ndërtimi dhe forma e skeletit të foshnjës dhe i një të rrituri?*

Dyshet diskutojnë dhe shënojnë përfundimet e tyre në fletoren e shënimeve. Tani anëtarët e dysheve “pro” dhe “kundër” ndahen, dhe ata duhet të bashkohen në çift me një anëtar tjetër, i cili po diskuton të njëjtin qëndrim. Ata duhet të krahasojnë arsyet për 4-5 minuta. Dyshet fillestare duhet të ribashkohen të krahasojnë shënimet dhe të paraqesin arsyet e argumentet kryesore, pra të debatojnë lidhur me to.

**Pjesa kryesore:**
Nxënësit vazhdojnë ashtu të ndarë në grupe dhe nga diagrami i prezantuar në fotografinë e librit nxjerrin pjesët ndërtuese të kockave. Nxënësit mund të nxjerrin edhe një përfundim të diskutimit që është zhvilluar në hapin e parë.
Nxënësit nga vrojtimi i modelit të skeletit të njeriut plotësojnë tabelën, të cilën e përgatit mësuesi/ ja për 6 grupet.

| Lidhjet e kockave | Ku i hasim L.K. në trupin tonë | Lëvizshmëria e tyre |
|---|---|---|
| Lidhja me dhëmbëza | Kafka | Të palëvizshme |
| Nyje të lëvizshme | Artikulacioni i dorës | Të lëvizshme |
| … | … | … |

Nxënësit prezantojnë plotësimin e tabelës dhe e komentojnë duke ardhur në përfundime se kyçet mund të jenë:
- lidhje të palëvizshme;
- nyje të lëvizshme;
- nyje gjysmë të lëvizshme.
- 

**Pjesa përfundimtare:**
Ftohen nxënësit që të shkruajnë një ese, për 10’ duke pas parasysh këto pika plani: *llojet e nyjave, fërkimi i nyjave, lëngu sinovial.*
Disa nxënës do të lexojnë esetë e krijuara.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësojnë komentet, diskutimet dhe shënimet e shkrimit të lexuar.
Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin në dyshe dhe grupe, diskutimin, përfundimet për ndërtimin e kockave, dallimin e nyjave dhe shkrimin e përpiluar mbi pikat e planit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Rendit nyjat e trupit tënd duke i dalluar ato.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla** e **kurrikulës**: III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës** - hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit muskulor. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2, I.5; II.6; II.7; III.3; | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore**: 1.7 Ndërtimi i sistemit muskulor | | | |
| **Fjalët kyçe**: muskuj të vijëzuar, muskuj të lëmuar, muskuli i zemrës, aktinë, miozinë. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- paraqet qëndrimet lidhur me pyetjen e shtruar;<br>- analizon ndërtimin e muskulit dhe ndarjen e tyre;<br>- përmbledh njohuritë e fituara për ndërtimin e muskujve.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- prezanto qëndrimet pro dhe kundër në pyetjen e shtruar;<br>- shpjego ndërtimin dhe llojet e muskujve përmes tabelës. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** atlas i ndërtimit të muskujve, fotografi. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore**: Gjuhën shqipe, Matematikë, Anatomi, Fiziologji<br>Çështjet ndërkurrikulare**:** Edukim për media | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Pjesa hyrëse:** *Brainstorming*<br>Mësuesi/ja u paraqet nxënësve fotografi ose një model plastik mësimor i trupit të njeriut ku tregohen organet dhe sistemet e organeve të trupit të njeriut. Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të thonë çfarë ata dinë rreth ndërtimit të trupit të njeriut. | | | |

**Pjesa kryesore:** Tabela e koncepteve
Mësimdhënësi u shpjegon nxënësve njësinë mësimore dhe i orienton që të lexojnë njësinë mësimore dhe në fletoret e tyre të formojnë një tabelë më tri kolona dhe të bëjnë krahasimin midis llojeve të muskujve: të lëmuar, të vijëzuar dhe muskulit të zemrës.

| Muskujt e vijëzuar | Muskujt e lëmuar | Muskuli i zemrës |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

**Pjesa përfundimtare:**
Harta e të pyeturit

"Harta e të pyeturit" është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin në dyshe dhe grupe, diskutimin, përfundimet për ndërtimin e muskujve, llojet e muskujve dhe paraqitjen ne tabelën e koncepteve.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rendit muskujt e trupit tënd duke i dalluar ata

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>-identifikon, lëndimet si dhe masat mbrojtëse të sistemit për lëvizje. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2, I.5; II.6; II.7; III.3; | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore**: 1.8 Dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit skeletor dhe atij muskulor | | | |
| **Fjalët kyçe**: osteoporoza, artriti, atrofia muskulore, skolioza, lordoza, kifoza etj. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- paraqet qëndrimet lidhur me pyetjen e shtruar;<br>- analizon shkaqet e paraqitjes së sëmundjeve;<br>- përmbledh njohuritë e fituara për sëmundjet e skeletit dhe muskujve.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>- prezanto qëndrimet pro dhe kundër në pyetjen e shtruar;<br>- shpjego sëmundjet e skeletit dhe muskujve përmes tabelës. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fotografi ku paraqiten sëmundjet e skeletit dhe muskujve. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore**: Gjuhë shqipe, Matematikë, Anatomi, Fiziologji.<br>Çështjet ndërkurrikulare**:** Edukim për media | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Pjesa hyrëse:** *Brainstorming*<br>Mësuesi/ja u paraqet nxënësve fotografi me sëmundjet e skeletit dhe muskujve dhe pyet për njohuritë paraprake rreth kësaj teme. | | | |

**Pjesa kryesore:** Tabela e koncepteve

Mësimdhënësi u shpjegon nxënësve njësinë mësimore dhe i orienton që të lexojnë njësinë mësimore dhe në fletoret e tyre të formojnë një tabelë më tri kolona, në kolonën e parë renditen sëmundjet, në kolonën e dytë renditen shkaqet e paraqitjes dhe në kolonën e tretë, simptomat e sëmundjes.

| **Sëmundjet e skeletit dhe të muskujve** | **Shkaqet e paraqitjes** | **Si manifestohet sëmundja (simptomat)** |
|---|---|---|
| Osteoporoza | | |
| Artriti | | |
| Atrofia muskulore | | |
| Skolioza | | |

**Pjesa përfundimtare:**

Diskutim rreth masave parandaluese të këtyre sëmundjeve.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin në dyshe dhe grupe, diskutimin, përfundimet për sëmundjet skeletit dhe muskujve, dhe paraqitjen në tabelën e koncepteve.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni rreth sëmundjeve të skeletit dhe muskujve dhe rreziqet e tyre.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës**: III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- përshkruan procesin dhe rrugën e tretjes së ushqimit te njeriu. | | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; I.2; II.4; II.6; III.3; III.5 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.<br>Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore**: 1.10 Tretja dhe pjesët e aparatit tretës. | | | |
| **Fjalët kyçe**: goja, ezofagu, lukthi, zorra e hollë, zorra e trashë. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>- emërton organet e aparatit të tretjes nëpër të cilin kalon ushqimi;<br>- shpjegon duke e përshkruar rrugën e ushqimit dhe roli i organeve të aparatit tretjes gjatë rrugëtimit të ushqimit;<br>- lidh çdo organ me funksionin e tyre përkatës.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- shëno organet e aparatit tretës sipas një renditjes logjike;<br>- sqaro ndryshimet që pëson ushqimi gjatë rrugëtimit të tij në aparatin e tretjes;<br>- bashkëngjit së paku 4 organe me funksionin që ato i kryejnë. | | | |
| **Burimet:** Libri i biologjisë, interneti.<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** CD me material nga *YouTube*-i për aparatin e tretjes, fletët A4 me fotografinë ku paraqitet trakti digjestiv dhe etiketat**.** | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Gjuhë angleze, Anatomi, Fiziologji.<br>Çështjet ndërkurrikulare**:** Edukimi për media; Arsimi për zhvillimin e qëndrueshëm | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Pjesa hyrëse:**<br>Mësuesi/ja fillon orën duke paraqitur një kllaster me shënimin "Organet e aparatit tretës" dhe kërkon nga nxënësit të plotësojnë detyrën, duke e plotësuar kllasterin me përgjigjet e tyre në tabelë. | | | |




**Pjesa kryesore:**
Mësuesi/ja tregon një video (të marrë në Y*ouYube*) ku tregohet udhëtimi i ushqimit në aparatin e tretjes, duke dhënë sqarime edhe mbi përpunimin e tij. Nga nxënësit kërkohet të mbajnë shënime, si dhe duke marrë parasysh informatat e librit, çdo dyshe thotë idenë e vet lidhur me kërkesat e prezantuara në tabelë, kurse mësuesi/ja plotëson tabelën në mënyrë të strukturuar.

| Aparati tretës | Shëno organet ndërtuese. | Ç'është tretja? | Sa lloje të ushqimeve na duhen? |
|---|---|---|---|
| | Goja, fyti, ezofagu, lukthi, zorra e hollë, zorra e trashë. | Përpunimi mekanik e kimik i ushqimit | 40 lloje |
| Goja | Çfarë përmban? | Si kryhet gëlltitja? | Kush lag ushqimin-Enzimi |
| | Dhëmbët, gjuhën, gjëndrat e pështymës. | Tkurren 25 muskujt e fytit Gjuha e shtyn poshtë ushqimin, kubeja e qiellzës lartë, ulet epiglotisi, ushqimi kalon në ezofag. | Pështyma-Amilaza |
| Ezofagu | Cilat organe lidh? | Llojet e muskujve-Emri? | Roli i ezofagut? |
| | Gojën-lukthin | Gjatësore, rrethore-Sfinkter | Lëvizja e ushqimit |
| Lukthi | Pozita në organizëm? | Roli? | Lëngjet e lukthit-Enzima? |
| | Pjesa e sipërme e barkut, në të majtë fill pas ezofagut. | Përzierja e ushqimit | Acidi klorhidrik -Pepsina |
| Zorra e hollë | Si duket sipërfaqja? | Si lëvizin muskujt-Si quhet | Roli? |
| | E rrudhosur | Me tkurrje-lëshime valore Lëvizje peristaltike | Tretja e plotë dhe thithja e përbërësve të molekulave të ushqimeve |
| Zorra e trashë | Çfarë përthithet | Gjendja e mbetjes? | Hidhet-emri? |
| | Uji | E trashë | Jashtë organizmit-Anus |

**Pjesa përfundimtare:**
Kërkohet nga nxënësit të ndahen në grupe ku do t'u shpërndaj fletat me figurën e prezantuar dhe kërkoj nga ata që të shënojnë pjesët e mësuara të aparatit në gjuhën angleze duke bashkëlidhur funksionin dhe rolin e tyre. Ftohen disa udhëheqës të grupeve të prezantojnë. Mësuesi/ja ndërhyn për përmirësime sipas rasti.

| |
|---|
| Me tkurrje-lëshime valore Lëvizje peristaltike.<br>Tretja e plotë |
| Përzierja e ushqimit. Tretja e ushqimit |
| Lëvizja e ushqimit. |

Përthithja e ujit. Largimi i ushqimit
Përpunimi mekanik i ushqimit.
Lag ushqimin.




## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit për përgjigjet e dhëna, lidhjen e organeve të aparatit tretës me funksionin që ato kryejnë si dhe bashkëpunimin në grup.
Mësuesi/ja vlerëson idetë lidhur me organet e aparatit të tretjes, përshkrimit të pozitës, rolit dhe funksionit të tyre, lidhjen e informatave në etiketa me organet përkatëse si dhe bashkëpunimin e tyre.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumto në burime të tjera a posedon aparati tretës organe të tjera të cilat ndihmojnë në tretjen e ushqimit.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës**: III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- vlerëson rolin e organeve të veçanta në procesin e tretjes. | | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2; III.3; III.5 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.<br>Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore**: 1.11 Përthithja e ushqimit në zorrë | | | |
| **Fjalët kyçe**: mëlçia, pankreasi, duodenumi, lëngu pankreatik, lëngu i tëmthit. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>- emërton organet gjëndërore të rëndësishme për tretjen e ushqimit;<br>- konstaton se tretjen e ushqimit e ndihmojnë, lëngjet e mëlçisë dhe pankreasit;<br>- shoqëron organet e tretjes, lëndët ushqyese me lëngjet tretëse, enzimat.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- trego si mëlçia e pankreasi mundësojnë tretjen e ushqimit;<br>- vërteto cilat lëndë ushqimore zbërthehen dhe përthithen;<br>- lidh mëlçinë, pankreasin, lëndët ushqyese me lëngjet tretëse-enzimat. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Detyrat e shtëpisë së nxënësit, fotografitë e prezantuara në libër, fletët A4 me detyrën për shoqërim. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Anatomi, Fiziologji.<br>Çështjet ndërkurrikulare**:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Pjesa hyrëse:**<br>Mësuesi/ja fillon orën duke kërkuar që nxënësit të lexojnë detyrën e shtëpisë mbi hulumtimin e bërë për organet e tjera të aparatit tretës që ndihmojnë tretjen. Nga detyra rezulton se mëlçia dhe pankreasi prodhojnë lëngje që ndihmojnë në tretjen e lëndëve ushqimore.<br>**Pjesa kryesore:**<br>Mësuesi/ja ndan nxënësit në dyshe dhe kërkon nga nxënësit të vëzhgojnë duke analizuar fotografitë të prezantuar në libër në faqen 28-29. Në dyshe, nxënësit shqyrtojnë: | | | |

- Cilat lëngje ndihmojnë zorrën e hollë në tretjen e ushqim pasi ai qëndroi në lukth 4 orë?
- Përshkruaje duke treguar funksionin e duodenumit?
- Ç'është përthithja? Cilat lëndë ushqimore i marrim fal saj? Si?
- Trego duke emërtuar enzimat në cilat lëndë i shndërrojnë: niseshtenë, glikogjenin, proteinat dhe yndyrën gjatë shpërbërjes?
- Sqaro lidhjen baktere-fibrat-feçes?
- Përse vitaminat dhe kripërat minerale nuk treten?

Konstatimet e dala nga shqyrtimi i përbashkët.
Në fund, nxënësit konstatojnë se lëngu pankreatik dhe ai i tëmthit ndihmojnë tretjen.
Ato derdhen në zorrën e hollë, e quajtur duodenumi, e cila përmban shumë vile (që rrisin sipërfaqja kontaktuese me zorrë) dhe mikrovilet (të pasura me shumë enë gjaku ku kalojnë lëndët e përthithura nga zorra).

- Pra, lëndët e përfituara nga zbërthimi i ushqimeve me origjinë të ndryshme (karbohidrate, yndyra, proteina) kalojnë në gjak përmes mureve të zorrëve të holla. Ky proces quhet përthithje.
- Niseshteja dhe glikogjeni shpërbëhen nga amilaza pankreatike deri në molekula glukoze. Lëngu pankreatik përmban edhe enzima që veprojnë mbi proteinat dhe i shpërbëjnë ato deri në aminoacide. Ndërsa yndyrat copëtohen (emulgohen) nga lëngu i tëmthit që vjen nga mëlçia dhe shpërbëhen nga enzimat deri në glicerol dhe në acide yndyrore. Të gjitha këto lëndë që përftohen si rezultat i shpërbërjes së ushqimit në zorrë, thithen nga qelizat e epitelit të saj dhe transportohen në të gjithë trupin me anë të gjakut dhe limfës.
- Bakteret shkatërrojnë shumë substanca organike që enzimat nuk janë të afta t'i tretin, vetëm një pjesë largohet nga trupi nëpërmjet anusit, në formën e feçes, ku i gjithë ushqimi i patretur dhe fibrat mblidhen në zorrën e trashë.
- Kripërat minerale dhe vitaminat nuk zbërthehen, sepse ato kalojnë direkt në gjak.

**Pjesa përfundimtare:**
Mësuesi/ja përgatit fletët A4 me detyrën e kërkuar. Pra, kërkon nga nxënësit të shoqërojnë organet me lëngjet përkatëse, lëndët ushqyese me enzimat.

| | |
|---|---|
| ➢ Mëlçia | - Lëngu pankreatikë |
| ➢ Pankreasi | - Amilaza |
| ➢ Yndyrat | - Lëngu i tëmthit |
| ➢ Nishesteja Ø Glikogjeni | |

Nxënësit në dyshe shkëmbejnë fletoret dhe vlerësojnë ato me anë të ngjyrës (e kuqe–jomirë; e verdhë – mesatar; e gjelbër–shkëlqyeshëm).

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë komentimit të rezultateve të hulumtimit të organeve të aparatit tretës përgjigjet gjatë shqyrtimit, shoqërimit të organeve tretëse me lëngjet tretëse.
Mësuesi/ja vlerëson përgjigjet e dala nga hulumtimi i bërë si detyrë shtëpie i përgjigjeve gjatë shqyrtimit, saktësinë e shoqërimit të organeve përkatëse me lëngjet e tyre tretëse, lëndëve ushqyese me enzimat apo lëngjet tretëse. Vlerësimin e ndërsjellë të tyre.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetjet 1, 2, 3, 4 në faqen 29, te libri i Biologjisë.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- vlerëson rolin e organeve të veçanta në procesin e tretjes. | | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** 2 I.2; II.5; III.3; III.7; III. 8 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.<br>Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore**: 1.12 Roli i mëlçisë dhe i pankreasit në procesin e tretjes | | | |
| **Fjalët kyçe**: mëlçia, pankreasi. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>-vëzhgon eksperimentin duke nxjerr përfundime lidhur me lëndët fillestare dhe ato të fituara;<br>-analizon vendndodhjen dhe funksionin e mëlçisë dhe të pankreasit;<br>-vlerëson rolin e enzimave për organizmin tonë.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>- nxirr përfundime lidhur me lëndën e fituar gjatë eksperimentit;<br>- përcakto pozitën dhe funksionin e mëlçisë dhe pankreasit përmes modelit-njeri;<br>- nxirr nga tabela 5 enzimat që ndihmojnë në procesin e tretjes. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë, klasa VII<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** 2 gota, ujë, vaj, detergjent i lëngët, gjysmëmodeli i njeriut, fletët A4. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Kimia, Anatomia, Fiziologjia.<br>Çështjet ndërkurrikulare**:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshme | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Pjesa hyrëse:**<br>Mësuesi/ja fillon orën duke kërkuar që nxënësit të vëzhgojnë eksperimentin e thjeshtë, të cilin e prezanton para nxënësve pa u treguar emërtimet e substancave. Shtron pyetjen:<br>Çfarë ndodhi? Çfarë përfundimi mund të nxirrni?<br>Nxënësit shënojnë një hipotezë mbi pyetjen: Çfarë ndodhi? | | | |

Përgjigjet e nxënësve diskutohen dhe nxjerrim një përfundim: detergjenti kur përzihet me vaj krijon të njëjtin efekt si përzierja e lëngut biliar me yndyrat, pra zbërthen yndyrat në njësi më të vogla (pikla të yndyrës).

**Pjesa kryesore:**
Mësuesi/ja vendos modelin e gjysmëtrupit të njeriut dhe kërkon nga nxënësit të mbajnë shënim për vetitë e mëlçisë dhe pankreasit d.m.th. të vëzhgojnë dhe të përshkruajnë organet si duken (forma), ngjyra, pozita.



Nxënësit shënojnë: Mëlçia gjendet në anën e djathtë të barkut, poshtë diafragmës, ndahet në dy pjesë, ka ngjyrë të kuqe të errët.
Pankreasi gjendet mes zorrës dymbëdhjetëgishtore e të shpretkës, formë gjuhe shpatuke dhe e pa ngjyrë.
Mësuesi/ja tani kërkon nga nxënësit të përzgjedhin materialin nga libri në një vijë logjike ku përshkruhet funksioni i dy organeve gjëndërore, mëlçisë dhe pankreasit. Nxënësit mund të përzgjedhin këto shënime:

**Funksionet e mëlçisë:**
**–** Depoziton sheqerin glukozë në formën e glikogjenit; shndërron aminoacidet e tepërta në sheqer; shndërron amoniakun në ure; zbërthen lëndët e dëmshme për organizmin; depoziton vitaminat; depoziton hekurin. Mëlçia prodhon lëngun biliar. Këtë lëng, ajo e depoziton në fshikëzën e tëmthit. Gjatë marrjes së ushqimit, lëngu biliar derdhet pak nga pak në zorrën dymbëdhjetëgishtore dhe ka për funksion të neutralizojë natyrën acidike të ushqimit që vjen nga lukthi. Ai ndihmon gjithashtu në zbërthimin e yndyrave. Më tej, ato vazhdojnë të ndahen në zorrën e hollë.

**Funksionet e pankreasit:**
- Pankreasi ka funksion të dyfishtë, prodhon hormone për të rregulluar sheqerin në gjak, 10 enzima tretëse, që ndihmojnë për zbërthimin kimik të ushqimit, përshpejtojnë zbërthimin e proteinave, të karbohidrateve dhe të yndyrave në molekula më të vogla e më të thjeshta, të cilat më pas kalojnë në gjak.
Mësuesi/ja zgjedh disa nxënës të lexojnë detyrën dhe ndërhyn sipas rastit.

**Pjesa përfundimtare:**
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të analizojnë tabelën dhe të reflektojnë rreth saj.
Enzimë – organi ku prodhohet funksioni.

| Enzima | Organi ku prodhohet | Funksioni |
|---|---|---|
| Amilaza | | |
| Pepsina | | |
| Proteaza | | |
| Karbohidraza | | |
| Lipaza | | |

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë diskutimit, përshkrimin e funksionit të organeve dhe analizën e tabelës enzimatike.
Mësuesi/ja vlerëson diskutimin, përfundimin nga eksperimenti, përshkrimin e pozitës dhe formës të organeve, përzgjedhjen e informatave mbi funksionin e organeve, analizës tabelare enzimatike dhe shënimin e rrjedhshmërisë të informatave.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të punohet eksperimenti në shtëpi duke e zëvendësuar detergjentin me lëngun biliar nga idhësa e pulës duke shënuar ecurinë e punës dhe përfundimet e dala.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës**: III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Ushtrime-Sistemi i tretjes | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- vlerësim i njohurive të marra, për sistemin e tretjes. | | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; I.6; II.5; III.8 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.<br>Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore**: Ushtrime - Sistemi i tretjes | | | |
| **Fjalët kyçe**: tretja dhe pjesët e aparat i tretjes, përthithja e ushqimit, mëlçia dhe pankreasi. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>- emërton organet e sistemit të tretjes, enzimave duke plotësuar hapësirat;<br>- shkruan saktë përgjigjet në pyetjet e dhëna;<br>- dallon saktësinë e fjalive duke i qarkuar to.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>- shëno së paku 4 organe duke treguar enzimat e tyre për zbërthimin e lëndëve ushqyese;<br>- përgjigju saktë me shkrim në 3 pyetjet e dhëna;<br>- vlerëso saktësinë e fjalive me anë të qarkimit. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** topi. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Kimi, Edukatë fizike Çështjet ndërkurrikulare**:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Pjesa hyrëse:**<br>Para kontrollimit vlerësues me shkrim bëjmë një aktivitet relaksues dhe një përsëritje të shpejtë. Mësuesi/ja merr një top dhe e kalon te disa nxënës duke iu shtruar pyetjet:<br><br>- Cilat organe janë ndërtuese të grupit tretës?<br>- Si bëhet gëlltitja e ushqimit? | | | |

- Trego disa lëndë ushqyese që fitohen gjatë zbërthimit të ushqimit.
- Përshkruaje si duket mëlçia dhe pankreasi.
- Emërto disa probleme të sistemit tretës.

Kjo bëhet për t'u dhënë kurajë dhe për të larguar mendjen nga plotësimi i ushtrimeve, me të cilat ata verifikojnë arritjen e rezultateve.

**Pjesa kryesore:**
Punohet në grupe, ushtrimet e faqes 31 të librit të Biologjisë. Lihet afat kohor për zgjidhjen e çdo ushtrimi, e pas përfundimit lexohen e diskutohen ushtrimet nga pjesëtarët të grupeve.
**Pjesa përfundimtare:**
Punohen në tabelë ushtrimet e zgjidhura saktë e mbahen shënim nga nxënësit e grupeve të tjera.
Mësuesi/ ja bën plotësimet e nevojshme.
Kjo orë nxit të nxënit në bashkëpunim te nxënësit, ku secili mëson nga njohuritë e shokut të tij dhe zhvillon mendimin kritik të pavarur me kompetencat kyçe të lëndës së Biologjisë.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për bashkëpunim në grupe gjatë punës pjesëmarrjes në diskutim, pra kemi vetëvlerësim dhe vlerësim nga shoqja/shoku. Nxënësi/ja kontrollon përparimin e tij.
Mësuesi/ja mbledhë informacione rreth mësimnxënies së nxënësit dhe temave që ai i zoton apo duhet plotësuar në vazhdimësi.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Përpilo gjithsej 5 pyetje lidhur me përshkrim, ndërtim, funksion, tretjen, shndërrim të lëndëve ushqyese dhe sëmundjet e organeve të sistemit tretës.

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës**: III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | **Rezultati i të nxënit të temës** - vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së sistemit të organeve të tretje. | | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; I.6; II.1; III.3; III.5 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut. | | | |

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore**: 1.13 Problemet e sistemit tretës dhe masat për mbrojtjen e tij.

**Fjalët kyçe**: çrregullimet, sëmundjet, problemet dhe imuniteti i sistemit të tretjes.

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**

- emërton problemet, sëmundjet e sistemit tretës dhe parandalimin e tyre;
- analizon problemet, sëmundjet e sistemit tretës si dhe masat parandaluese;
- argumenton qëndrimet e tij/saj lidhur me rëndësinë e shëndetit të lukthit në mbrojtjen e organizmit;
- arsyeton së paku me 1-2 arsye qëndrimet pro dhe kundër për rëndësinë e shëndetit të lukthit në mbrojtjen e organizmit.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku 2-3 faktorë, të problemeve dhe sëmundjeve të sistemit tretës;
- Sqaro duke shpjeguar së paku 2-3 masa parandaluese të 2-3 problemeve, sëmundjeve të sistemit tretës;
- Arsyeto së paku me 1-2 arsye qëndrimet pro dhe kundër për rëndësinë e shëndetit të lukthit në mbrojtjen e organizmit**.**

**Burimet:** Libri i Biologjisë, klasa VII
**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri, fletorja lapsi, fotografi

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Kimi.
Çështjet ndërkurrikulare**:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Pjesa hyrëse:**
Mësuesi/ja fillon orën duke i shënuar në tabelë fjalët dhe kërkon që secili nxënës të shkruajnë gjithçka çka din për fjalët e shënuara (duke u caktuar koha): *kapsllëk, diarre, obezitet, bulimia, ulcera e lukthit*
Lexojmë disa punime të nxënësve duke pasur kujdes që gjatë leximit të mos i përsëritim gjithnjë informatat e njëjta.

**Pjesa kryesore:**
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që në dyshe lexojnë tekstin duke shënuar fjalitë mbi tekstin:
**F**-fakt; **Sh**-shkaku/qe; **P**-pasoj/ja. Më pas, ata plotësojnë tabelën duke i shënuar të gjitha shënimet në grupin, shtyllat përkatëse.

| **Fakte** | **Shkaqe** | **Pasoja** |
|---|---|---|
| - Ato qëndrojnë në zorrën e trashë për një kohë relativisht të gjatë dhe për pasojë, thahen e forcohen. | - Për shkak të faktorëve të ndryshëm, sistemi i tretjes mund të pësojë çrregullime, të cilat krijojnë vështirësi sidomos në nxjerrjen e mbetjeve (feçeve) nga organizmi. | - Kapsllëk |
| - Këto dalje janë aq të shpeshta, sa bën që trupi të dehidratohet (të humbasë ujë). Diarreja | Kur zorra e trashë është e acaruar, koha për përthithjen e ujit prej saj nuk është e mjaftueshme. Për këtë arsye, uji del jashtë bashkë me mbetje. | - Diarreja |
| - Për shkak të një sërë faktorëve, ndër të cilët mund të përmendim kequshqyerjen, problemet emocionale që lidhen më së shumti me ndryshimin hormonal, faktori social etj. Të gjithë këto mund të shkaktojnë edhe probleme fizike të sistemit tretës, siç është ulcera e lukthit. | Bakteri *Helicobakter pylori*. Shkaku kryesor i shfaqjes së ulcerës është duhanpirja, konsumimi i alkoolit, marrja e shpeshtë e barnave antiinflamatore, si aspirina dhe ibuprofeni dhe sidomos kequshqyerja. | - Ulcerat e lukthit |
| ... | ... | ... |

Në këtë mënyrë vazhdon plotësimi i tabelës. Nxënësit përfundojnë detyrën, lexohet klasifikimi i informatave në mënyrë tabelare nga disa dyshe, kurse mësuesi/ja njëkohësisht plotëson një të tillë në tabelë. Gjatë plotësimit të tabelës, mësuesi/ja ndërhyn për shpjegimet e plotësimet e nevojshme.

**Pjesa përfundimtare:**

Mësuesi/ja ndan nxënësit në dy grupe të mëdha ku nxënësit që kanë numra tek në ditarë do të mbajnë qëndrimin **po,** kurse nxënësit me numrat çift do të mbajnë qëndrimin **jo** në pyetjen: "A luan rol shëndeti i lukthi  në mbrojtjen e organizmit?"

PO JO

- A luan rol shëndeti i lukthi në mbrojtjen e organizmit?

Nxënësit shkruajnë idetë e tyre dhe më pas një përfaqësues i grupit prezanton argumentet e dala nga plotësimi i tabelës.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për bashkëpunim në dyshe gjatë plotësimit të tabelës, shprehjes dhe mbajtjes të qëndrimit vet.

Mësuesi/ja vlerëson shënimin e ideve të tyre mbi temën e dhënë, mbajtjen e shënimeve dhe saktësinë e tyre lidhur me shkaqet dhe pasojat të problemeve, sëmundjet dhe mënyrat parandaluese të sistemit tretës. Vlerësohen edhe për pjesëmarrjen e tyre në diskutim.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shëno kërkimet e informacioneve mbi sëmundjet e sistemit tretës nga burime të tjera.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës**: III | **Klasa:** VII |
| **Tema**: Sistemet e organeve të njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës** Hulumton përbërjen, rolin dhe rëndësinë e përbërësve të gjakut dhe limfës. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2, I.5; II.6; II.7; III.3; | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore**: 1.14 Elementet përbërëse të gjakut dhe të limfës. Roli i tyre. | | | |
| **Fjalët kyçe**: gjaku, limfa, plazma, eritrocite, leukocite, trombocite. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- paraqet qëndrimet lidhur me pyetjen e shtruar;<br>- analizon përbërjen e gjakut;<br>- përmbledh njohuritë e fituara për rolin e limfës në organizëm.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>- numëron përbërësit e gjakut;<br>- shpjegon rolin e elementeve të gjakut. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** video për elementet e gjakut. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore**: Gjuhë shqipe, Matematikë, Anatomi, Fiziologji.<br>Çështjet ndërkurrikulare**:** Edukim për media | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Pjesa hyrëse:** *Brainstorming*<br>Mësuesi/ja u paraqet nxënësve një video dhe pyet për njohuritë paraprake rreth kësaj teme. | | | |

**Pjesa kryesore:** Tabela e koncepteve
Mësimdhënësi u shpjegon nxënësve njësinë mësimore dhe i orienton që të lexojnë njësinë mësimore dhe në fletoret e tyre të formojnë një tabelë më tri kolona .

| **Elementet e gjakut** | **Përbërja** | **Roli** |
|---|---|---|
| Eritrocitet | | |
| Leukocitet | | |
| Trombocitet | | |
| Limfa | | |

....

**Pjesa përfundimtare:**

Ese rreth gjakut dhe përbërësve të tij, roli dhe rëndësia.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin në dyshe dhe grupe, diskutimin, përfundimet për gjakun dhe elementet e tij.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përgjigjuni pyetjeve në faqen 35 nga Biologjia 7.

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës**: III | **Klasa:** VII |

**Tema**: Sistemet e organeve të njeriut

**Rezultati i të nxënit të temës**
- analizon ndërtimin dhe punën e zemrës.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2, I.5; II.6; II.7; III.3;

**Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore**: 1.15 Zemra dhe funksionet e saj

**Fjalët kyçe**: parabarkushet, barkushet, nyja sinoatriale, pulsi i presionit të gjakut, sistolë, diastolë.

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- përshkruan ndërtimin e zemrës;
- përmbledh njohuritë e fituara për rolin e zemrës në organizëm.

**Kriteret e suksesit:**
- përshkruaj rrugët që ndjek gjaku në zemër;
- përkufizo termet sistolë dhe diastolë.

**Burimet:** Libri i Biologjisë 7
**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** video për ndërtimin e zemrës

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore**: Gjuhë shqipe, Matematikë, Anatomi, Fiziologji.
**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me ndërtimin e neuroneve, qelizave gliale dhe llojeve të neuroneve.
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit rreth njohurive që kanë për ndërtimin dhe lidhjet që kanë pjesët ndërtuese të neuronit, rolin që ka mielina dhe ngushtimet e Ranviesë në përcjelljen e ngacmimit nervor.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyra 4, faqe 61.

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës</td><td>Lënda: Biologji</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Sistemet e organeve te njeriut</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>-hulumton ndërtimin dhe funksionin e sistemit nervor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.4; II.5;II.6; III.1; III.5</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: 1.29 Ndarja e sistemit nervor</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: sistem nervor qendror, sistemi nervor periferik, autonom, somatik, simpatik, truri, parasimpatik, palca kurrizore, talamusi, hipotalamusi, hulli, dredha.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>-tregon pjesët kryesore të sistemit nervor;<br>-përshkruan lidhjet që ka midis sistemit nervor qendror dhe atij periferik;<br>-analizon rolin sistemit simpatik e parasimpatik në punën e organeve të ndryshme.<br>Kriteret e suksesit:<br>- rendit pjesët kryesore të sistemit nervor;<br>- shëno ndarjet e sistemit nervor periferik;<br>- shqyrto punën e dy prej organeve, duke treguar lidhjen e sistemit parasimpatik me atë simpatik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet: Libri i Biologjisë 7<br>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tabela e ndarjeve të sistemit nervor, tabela e vlerësimit të rolit që ka sistemi parasimpatik e simpatik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhë shqipe, Anatomi, TIK.</td></tr>
<tr><td colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Pjesa hyrëse:<br>Mësuesi/ja hedh në diskutim informacionet mbi nervat dhe organet që janë pjesë e sistemit nervor. Diskutimi ndalon tek organizmi i sistemit nervor qendror me trurin dhe palcën e kurrizit.<br>Përshkruan ndarjen e parë të sistemit: rrugët hyrëse dhe dalëse të sistemit nervor periferik. Rolin që ato kanë në marrjen dhe dërgimin e ngacmimeve të ndryshme nga brenda trupit dhe mjedisit përreth.</td></tr>
</table>

**Pjesa kryesore:**
Mësuesi/ja vendos nxënësit të lexojnë mësimin e nëpërmjet një organizuesi grafik tregon ndarjet që ka sistemi nervor duke i diskutuar secilën prej tyre me nxënësit.




**Pjesa përfundimtare:**
Mësuesi/ja ndan nxënësit në dy grupe. Secili grup shqyrton rolin që kanë sistemet simpatike e parasimpatike. Kryetari i grupit që zgjidhet nga nxënësit, shkruan në tabelë në formë të përmbledhur

| S.N. P | S.N.S |
|---|---|
| ngushtimi i bebes së syrit | zgjerimi i bebes së syri nxit |
| gjëndrat e pështymës | frenimi i gjëndrave të pështymës |
| frymëthithje | frymënxjerrje |
| ulje të rrahjeve të zemrës | rritje e rrahjeve të zemrës |
| rritje e aktivitetit të lukthit | ngadalësim i punës së lukthit frenimi |
| i prodhimit të glukozës | nxitje e prodhimit të glukozës nxitje e aktivitetit të |
| zorrëve | frenimi i aktivitetit të zorrëve të holla sekretimi ADH |
| tkurrje e fshikëzës së urinës | lëshim i fshikëzës së urinës |

## VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me ndërtimin e sistemit nervor në tërësi, si dhe pjesëve të ndryshme të tij.
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit rreth njohurive që dinë për ndërtimin dhe lidhjet që kanë pjesët ndërtuese të sistemit nervor qendror dhe atij periferik, si dhe për bashkërendimin e punëve të pjesëve të ndryshme të sistemit nervor.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pse themi që sistemi nervor simpatik dhe ai parasimpatik kundërshtojnë njëri-tjetrin?

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Sistemet e organeve te njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- analizon ndërvarësinë e pjesëve të sistemit nervor. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br>I.3;I.4; III.3 ; III.2'; III.7; I.6 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore: 1.30** Bashkërendimi i pjesëve të sistemit nervor | | | |
| **Fjalët kyçe:** funksion ndijor, përzgjedhës, ruajtës i informacionit, receptorë, receptorë mekanikë, të temperaturës, të dhembjes, elektromagnetikë, kimikë. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- tregon funksionet kryesore të sistemit nervor;<br>- përshkruan ndërtimin e receptorit dhe llojet e tij;<br>- analizon rrugëtimin e ngacmimit nervor nga receptorët te SNQ.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>-veço dy prej funksioneve kryesore të sistemit nervor;<br>-trego natyrën e receptorit dhe llojet e tij;<br>-shpjego rrugën që ndjek ngacmimi nga receptori drejt sistemit nervor qendror. | | | |
| **Burimet:** Libri i Biologjisë 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fotografi të ndryshme të receptorëve, tablo të organizimit anatomik të sistemit nervor. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, Anatomi, TIK. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Pjesa hyrëse:**<br>Mësuesi/ja lejon nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimit deri te receptorët. Nëpërmjet një diskutimi, rendit në tabelë funksionet e sistemit nervor, si dhe përshkruan momentet kryesore për çdo funksion të sistemit nervor. | | | |

Funksionet kryesore të sistemit nervor:
- ndijor;
- lëvizor;
- përzgjedhës i informacionit;
- ruajtës i informacionit.

**Pjesa kryesore:**
Mësuesi/ja drejton nxënësit në leximin e pjesës së dytë deri te rrugëtimi i ngacmimit nervor nga receptorët te SNQ.
Nxënësit grupojnë receptorët sipas detyrave të specializuara që ata kanë dhe arsimtari/ja nxit nxënësit të sjellin shembuj nga jeta e përditshme, ku takojnë punën e këtyre receptorëve.
Më pas kalohet në leximin e fundit të mësimit për të vazhduar me argumentimin se si ngacmimi nervor kapet nga receptorët drejt sistemit nervor qendror. Nxënësit e ndarë paraprakisht në dy grupe, diskutojnë fillimisht për procesin që ndodh në këtë rrugëtim e më pas rëndësinë e fushave parësore e shoqëruese në raste të dëmtimit të një fushe të caktuar, p.sh: fusha e të parit.

**Pjesa përfundimtare:**
Mësuesi/ja hedh pyetje që përmbyllin mësimin, duke nxjerrë momentet kryesore nga dëmtimet e fushës së të parit.
Çfarë ndodh me pacientin kur dëmtohet plotësisht fusha parësore e të parit?
Kur një pacienti i ndodh verbërimi i plotë?
Çfarë ndodh nëse dëmtohet fusha shoqëruese e të parit?
Dëmtimi që pëson ndonjë pjesë e fushës parësore, shoqërohet me pamundësinë për të parë në një pjesë të fushës pamore. Në objektin që vëzhgojmë (kur nuk kemi mundësi të shikojmë), formohet një "vrimë". Dëmtimi i plotë i një fushe pamore (të një gjysmërruzulli) çon në humbjen e aftësisë së gjysmës së fushës pamore të dy syve. Kurse dëmtimi i plotë i të dyja fushave pamore të dy gjysmërruzujve shpie në verbim të plotë. Dëmtimi i fushës shoqëruese nuk shkakton as verbim, as "vrimë" në fushën pamore, por mosnjohje pamore.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me funksionet e sistemit nervor, si dhe bashkërendimit të punës nga receptori drejt sistemit nervor qendror.
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit rreth njohurive që kanë për funksionet kryesore të sistemit nervor, llojeve të receptorëve, koordinimit ndërmjet receptorëve dhe sistemit nervor qendror.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyra 4, f. 66.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Sistemet e organeve te njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>- analizon harkun refleksiv. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** I.3; I.6; III.3; III.7 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**<br>Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore: 1.31** Sinapsi. Harku refleksiv | | | |
| **Fjalët kyçe:** refleks, ndijim, përceptim, receptor | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>- rendit pjesët ndërtuese të sinapsit;<br>- rendit organet që marrin pjesë në ndërtimin e harkut refleksiv;<br>- analizon rrugën e veprimit të harkut refleksiv.<br>-<br>**Kriteret e suksesit:**<br>-emërto dy nga pjesët ndërtuese të një sinapsi;<br>-skico një hark refleksiv;<br>-arsyeto mënyrën se si vepron harku refleksiv në formimin e një ndijimi dhe perceptimi. | | | |
| **Burimet:** Libri Biologjia 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** foto të sinapsit, fotografi të harkut refleksiv. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuha shqipe, Anatomia. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Pjesa hyrëse:**<br>Mësuesi/ja demonstron para klasës një hark refleksiv duke pasur si objekt një nxënës. Godet me çekiç poshtë gjurit të nxënësit dhe ngacmon receptorët. Thekson se receptori i ngacmuar dërgon ngacmime përgjatë neuronit ndijor në palcën kurrizore. Ngacmimi më pas përçohet me anë të neuronit lëvizor te muskuli i kofshës, i cili tkurret me shpejtësi dhe ngre pjesën e poshtme të këmbës. | | | |

| |
|---|
| **Pjesa kryesore:**<br>Nxënësit diskutojnë rreth figurës në faqen 73 dhe komentojnë ngjarjet në harkun refleksiv. Ata tregojnë se si dërgohen ngacmimet nëse ngacmohet muskuli. Ngacmimi dërgohet nga receptori i ndjeshmërisë në dorën tonë. Ai dërgohet në palcën kurrizore me neuronin ndjesor.<br>Një nxënës del në dërrasë dhe vizaton skemën e harkut refleksiv. |
| **Pjesa përfundimtare:**<br>Mësuesi/ja drejton pyetje mbi sinapsin dhe harkun refleksiv.<br>1- Cila është rëndësia e refleksiv?<br>2- Përshkruani dy reflekse të ndryshme.<br>3- Ku ndodhen neurotejçuesit?<br>4- Çfarë është sinapsi? Po hapësira sinaptike? |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE:** |
| Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me sinapsin dhe harkun reflkesiv.<br>Mësuesi/ja vlerëson nxënësit rreth njohurive që kanë për ndërtimin e sinapsit, harkut refleksiv, mënyrën e funksionimit te sinapsit dhe harkut refleksiv si dhe formimit te ndjesive dhe perceptimeve te tyre. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrat 3, 4, f. 73. |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Sistemet e organeve te njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Analizon mundësinë për kujdesin ndaj sistemit nervor dhe pasojat në rast dëmtimi. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** I.3; I.6; III.3; III.7. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**<br>Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmëria e ekosistemeve, ndërtimi dhe funksioni i sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore: 1.32** Dëmtimet e sistemit nervor dhe pasojat e tyre | | | |
| **Fjalët kyçe:** paraliza cerebrale, hemorragjia cerebrale, droga. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**<br>-Argumenton pse truri konsiderohet më i shpejtë se kompjuteri.<br>-Tregon cilët janë disa nga faktorët kryesorë që dëmtojnë sistemin nervor.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>-Tregon simptomat e hemorragjisë cerebrale.<br>-Shpjegoni rreziqet e përdorimit të drogave. | | | |
| **Burimet:** Libri i biologji klasa 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja, lapsi, foto të dëmtimeve të sistemit nervor. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuha shqipe, Anatomi | | | |
| **Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:** | | | |
| **Pjesa hyrëse:**<br>Mësuesi/ja bën një bashkëbisedim me nxënësit/et për njohuritë që kanë për dëmtimet e trurit, dhe bën një pyetje se cilët janë dëmtuesit e trurit, kurse nxënësit/et japin përgjigjet e tyre.<br>**Pjesa kryesore:** Veprimtari me lexim të drejtuar<br>Mësuesi/ja i ndan nxënësit/et në tri grupe, i udhëzon që secili grup të lexojnë pjesën e dhënë për një kohë të caktuar pastaj fillon t'ju bëjë pyetje. Nxënësit/et japin përgjigjet e tyre mësuesi/ja i plotëson. | | | |

**Pjesa përfundimtare:** Tabela e koncepteve
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që njohuritë e fituara t'i vendosin në tabelën e koncepteve

| Dëmtuesit e sistemit nervor | Çfarë janë | Simptomat |
|---|---|---|
| Droga | | |
| Hemorragjia cerebrale | | |
| Paraliza cerebrale | | |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me dëmtuesit e sistemit nervor.
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et rreth njohurive që kanë për dëmtuesit e sistemit nervor dhe masat parandaluese.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Detyrat 3- 4, faqe 70, Biologjia 7.

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës</td><td>Lënda: Biologji</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Sistemet e organeve te njeriut</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Emërton dhe përshkruan organet shqisore: shqisën e të parit shqisën e të dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore, si dhe analizon funksionet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.4; IV.7; III.3; II.5;VI.1; III.8.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: 1.33 Organet shqisore: të parit dhe të dëgjuarit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: receptorë shqisorë, syri, veshi, gjuha, lëkura, hunda, retina, sklera, bebëza, thjerrëza, konet dhe kleçkat, veshi i jashtëm, i mesëm, i brendshëm, organi i kortit, organi i ekuilibrit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>-Liston organet e shqisave<br>-Përshkruan ndërtimin e syrit dhe të veshit.<br>-Analizon mënyrën se si fokusohet pamja mbi retinë dhe se si vala zanore kthehet në dridhje.<br><br>Kriteret e suksesit:<br>-Trego së paku dy prej organeve shqisore.<br>-Rendit pjesët përbërëse të ndërtimit anatomik të syrit dhe veshit.<br>-Vlerëso rolin e fotoreceptorëve dhe receptorëve akustik për pranimin e nxitjeve dhe shndërrimi i tyre në impulse.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet: Libri i biologjisë së klasës 7<br>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fletorja, lapsi, tablo të ndërtimi anatomik të syrit dhe të veshit.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, anatomi, TIK

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

Pjesa hyrëse:
Mësuesi/ja u tregon nxënësve fotografi të shqisave të ndryshme të trupit. Ata bëjnë një klasifikim të tyre.




Duke renditur organet e shqisave, bëhet një përshkrim i shkurtër për shqisën, ku ndodhet dhe çfarë detyre ka ajo.

**Pjesa kryesore:**
Mësuesi/ja porosit nxënësit/et të sjellin në klasë fotografi të ndërtimit të syrit dhe të veshit. Ai/ajo paraqet ndërtimin e syrit dhe e konkretizon çdo ndërtim para nxënësve. Nxënësit/et në dyshe studiojnë ndërtimin e syrit, pjesët përbërëse të tij. Pjesa e syrit që përmban qeliza receptore është retina. Pjesa e përparme e syrit është e mbuluar nga një membranë e hollë konjunktive. Mbulesa e fortë quhet sklera. Secila nga dyshet realizon një analizë të retinës dhe të irisit. Shkruajnë në tabelë ato çfarë analizuan. E njëjta situatë përsëritet edhe për ndërtimin e veshit, si dhe për funksionin e çdo strukture ndërtimore

**Pjesa përfundimtare:**
Mësuesi/ja përmbledh njohuritë e dhëna duke u fokusuar në ndryshimin që bën rrezja e dritës te syri në ngacmim nervor për të parin, si dhe tingulli te veshi në ngacmim nervor dhe në organin e ekuilibrit.
1.Truri mund të ndërtojë një pamje të qartë kur drita është e fokusuar mbi fovean. Shpjegoni përse.
2.Renditni sipas radhës pjesët e syrit në të cilat kalon drita për të arritur në retinë.
3.Renditni sipas radhës pjesët e veshit në të cilat kalon dridhja apo tingulli derisa të shkojë në organin e Kortit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me ndërtimin e syrit dhe të veshit, si dhe me rolin që kanë këto dy organe në kapjen e rrezeve të dritës, tingullit apo dridhjeve.
Arsimtari/ja vlerëson nxënësit/et rreth njohurive që kanë për ndërtimin dhe lidhjet që kanë pjesët ndërtuese të syrit dhe të veshit në kthimin e rrezeve të dritës dhe tingullit në ngacmim nervor.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyrat 3-4, faqe 72, Biologjia 7.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Sistemet e organeve te njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Emërton dhe përshkruan organet shqisore: shqisën e të parit shqisën e të dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore, si dhe analizon funksionet e tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** I.4; IV.7; III.3; II.5;VI.1; III.8. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore: 1.34** Organet e tjera shqisore | | | |
| **Fjalët kyçe:**, gjuha, sytha shijorë, papilla të shijes, lëkura, hunda, organi i ekuilibrit. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>-Liston llojet e shijeve<br>-Përshkruan ndërtimin e hundës dhe rolin e saj në nuhatje.<br>-Analizon receptorët e lëkurës<br>**Kriteret e suksesit:**<br>-Trego kush i ngacmon receptorët e shijes.<br>-Rendit pjesët përbërëse të ndërtimit anatomik të syrit dhe veshit.<br>-Vlerëso rolin e fotoreceptorëve dhe receptorëve akustik për pranimin e nxitjeve dhe shndërrimi i tyre në impulse. | | | |
| **Burimet:** Libri i biologjisë së klasës 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja, lapsi, foto të shqisave të shijes, nuhatjes dhe të prekurit | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, anatomi, TIK | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** | | | |

**Pjesa hyrëse:**
Mësuesi/ja vendos para nxënësve ushqime me shije të ndryshme dhe aroma të ndryshme udhëzon nxënësit/et t'i provojnë ato duke i konsumuar.

Pasi provojnë ushqimet bëhet një përshkrim i shkurtër për shqisën, ku ndodhet dhe çfarë detyre ka ajo, duke plotësuar një skicë.




**Pjesa kryesore:** D.R.T.A
Në këtë pjesë, mësuesi/ja ndan njësinë mësimore dhe udhëzon nxënësit/et të lexojnë pjesën e parë. Pas leximit, mësuesi/ja bën pyetje kurse nxënësit/et japin përgjigje, kështu vazhdohet edhe me pjesët e tjera.
**Pjesa përfundimtare:**
Mësuesi/ja bën një aktivitet të ekuilibrit me nxënësit/et: u kërkon nxënësve të praktikojnë ushtrime ekuilibri, të tilla si qëndrimi në një këmbë, qëndrimi në tra ekuilibri ose rrotullimi mbi top ekuilibri. Diskuton me nxënësit/et rreth faktit që sistemi i drejtpeshimit është ai që na ndihmon të qëndrojmë të ekuilibruar dhe se sytë, muskujt dhe nyjat tona luajnë gjithashtu një rol në këtë gjë. Ju kërkon nxënësve të mbyllin sytë, të mbështeten në karrige dhe të rehatohen. Duke vazhduar t'i mbajnë sytë mbyllur gjatë gjithë kohës, kërkon që të zgjasin dorën dhe me gishtin tregues të prekin majën e hundës së tyre.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me shqisat e shijes, nuhatjes, prekurit si dhe me rolin që kanë këto shqisa.
Arsimtari/ja vlerëson nxënësit/et rreth njohurive që kanë për shqisat e shijes, nuhatjes, të prekurit, si dhe rolin që kanë këto shqisa.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyrat 1-3,faqe 74, Biologjia 7.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Sistemet e organeve te njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon dëmtimet dhe masat mbrojtëse të shqisave. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** I.4; IV.7; III.3; II.5;VI.1; III.8. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore: 1.35** Dëmtimet e shqisave dhe masat për mbrojtjen e tyre | | | |
| **Fjalët kyçe:** miopia, hipermetropia, prezbiopia, astigmatizmi, daltonizmi. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>-Liston problemet që hasen në shqisën e të parit;<br>-Shpjegon a mund të korrigjohet daltonizmi nëpërmjet thjerrave të syzeve.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>-Tregon faktorët që mund të çojnë në dëmtimin e veshëve. | | | |
| **Burimet:** Libri i biologjisë së klasës 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja, lapsi. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Anatomi, TIK. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Pjesa hyrëse:**<br>Mësuesi/ja u bën një pyetje të hapur nxënësve rreth dëmtimeve të syve dhe veshit. Nxënësit/et japin përgjigjet e tyre. | | | |

**Pjesa kryesore:** Tabela e koncepteve
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që njohuritë e fituara t'i vendosin në tabelën e koncepteve

| **Çrregullimi** | **Struktura e syrit** | **Pamja** |
|---|---|---|
| Miopia | | |
| Hipermetropia | | |
| Astigmatizmi | | |
| Prezbiopia | | |

**Pjesa përfundimtare:**
Mësuesi/ja përmbledh njohuritë e dhëna përmes një diskutimi rreth faktorëve që shkaktojnë infeksionet e veshit dhe rëndësinë që ka dylli.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me dëmtimet e syrit dhe veshit.
Arsimtari/ja vlerëson nxënësit/et rreth njohurive që kanë për dëmtimet e syrit dhe veshit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Bëni një hulumtim rreth masave parandaluese të infeksionit të veshit.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës**: III | **Klasa:** VII |
|---|---|---|---|
| **Tema**: Sistemet e organeve te njeriu | **Rezultati i të nxënit të temës**<br>Vlerësim i njohurive të marra, për receptorët ndijorë | | |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; I.6; II.5; III.8.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës**: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.
Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore**: 1.38 Punë praktike: Receptorët ndijorë

**Fjalët kyçe**: Frymëmarrje, diafragma

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:**
-Përshkruani në fletore ndjesitë e secilës dorë kur i futët në ujë të vakët.

**Kriteret e suksesit:**
-Shpjegoni pse numri i pikave që përfaqësojnë ndjesinë e të ftohtit është i barabartë ose i ndryshëm nga numri i pikave që përfaqësojnë ndjesinë e të nxehtit.

**Burimet:** Libri i biologjisë klasa e 7
**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** termometër, dy kruajtëse dhëmbësh, dy gozhdë (10 cm) me majë të mprehtë, stilolaps me bojë që mund të lahet, peceta letre, tri enë të mëdha.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, matematikë, kimi, edukatë fizike Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Për realizimin e kësaj pune praktike, nxënësit/et mund të punojnë në grupe ose në dyshe.

**Eksperimenti 1**
Në enën e parë hidhni ujë të nxehtë. Matni temperaturën e tij dhe shtoni ujë derisa termometri të tregojë 45-50°C.

Në enën e dytë hidhni ujë të ftohtë me copa akulli.
Futni njërën dorë në enën me ujë të ngrohtë dhe dorën tjetër në enën me ujë të ftohtë.
Pas një minute nxirrini duart nga uji.
Tani futini duart në një enë të mbushur me ujë të vakët.
Përshkruani në fletore ndjesitë e secilës dorë kur i futët në ujë të vakët.

**Eksperimenti 2**
(Ky eksperiment duhet të zhvillohet në grupe me nga dy nxënës).
Futni njërën gozhdë në ujë të nxehtë dhe tjetrën në ujë të ftohtë me akull.
Në anën e brendshme të nyjës së dorës, njëri nga nxënësit/et do të vizatojë njëqind pika, largësia midis të cilave duhet të jetë 5 mm.
Figura që formohet, i ngjan një katrori të mbushur me pika, ku secila anë ka nga 10 pika.
Të njëjtin vizatim, nxënësi/ja e bën edhe në fletoren e punës.
Më pas, ai vendos mbi tavolinë dorën me nyjën të kthyer lart.
Nxënësi/ja tjetër merr gozhdën nga ena e nxehtë dhe pasi fshin majën e saj me një pecetë letre, e vendos atë (majën) në të gjitha pikat e katrorit të vizatuar në nyjën e dorës së shokut.
Pas çdo vendosjeje të majës së gozhdës në pikat e katrorit, nxënësi/ja pyetet nëse e ndien apo jo të nxehtin e saj.
Për çdo pikë në nyjën e dorës ku ndihet e nxehta, qarkohet me të kuqe në fletore pika përkatëse.
E njëjta procedurë ndiqet edhe për gozhdën e vendosur në ujë të ftohtë.
Për të ftohtin, pikat e vizatuara në fletore do të qarkohen me ngjyrë të kaltër.

**Vlerësimi i nxënësve**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për bashkëpunim në grupe gjatë punës pjesëmarrjes në eksperimente, pra kemi vetëvlerësim dhe vlerësim nga shoqja/shoku. Nxënësi/ja kontrollon përparimin e tij. Mësuesi/ja mbledhë informacione rreth mësimnxënies së nxënësit/et dhe temave që ai i zoton apo duhet plotësuar në vazhdimësi.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Sistemet e organeve te njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Emërton gjëndrat me tajitje të brendshme te njeriu dhe përshkruan pozitën e tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** III.5; I.4; II.6; II.7; III.7; III.8. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore: 1.36** Gjëndrat me tajitje të brendshme | | | |
| **Fjalët kyçe:** gjëndrat me tajitje të brendshme, lajmëtarë kimikë, hormon, *feed-back negativ* | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>**1.** Përshkruan konceptet hormone dhe gjëndër endokrine;<br>**2.** Rendit gjëndrat e rëndësishme endokrine;<br>**3.** Shpjegon funksionin e gjëndrave endokrine dhe hormonet që sekretojnë këto gjëndra;<br>**4.** Krahason sistemin nervor me atë endokrin.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>**1.** Emërto dy-tri nga gjëndrat endokrine në trupin e njeriut;<br>**2.** Interpreto një funksion të një gjëndre me hormonin që ai sekreton dhe rolin e tij;<br>**3.** Dallo sipas ndërtimit dhe funksionit sistemin nervor me atë hormonal. | | | |
| **Burimet:** Libri i biologjisë së klasës 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja, lapsi, tabela të gjëndrave të ndryshme endokrine në trupin e njeriut. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Anatomi, TIK | | | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse:**
Mësuesi/ja krijon një situatë me nxënësit. Iu drejtohet atyre për një kontroll të njohurive të marra në orën e mëparshme të mësimit. Nxënësit/et reagojnë në mënyra të ndryshme. Më pas, mësuesi/ja iu drejtohet nxënësve me pyetjen:

• Çfarë ndodhi me ju në çastin që ju njoftova për një kontroll të papritur?
Nxënësit/et përgjigjen: U frikësuam, u nervozuam, u emocionuam...
U tregon nxënësve se në atë moment, tek ata është liruar një substancë kimike, që kalon nga një pjesë e trupit te tjetra. Kjo substancë quhet hormon.

Hormonet ⟶ nga gjëndra ⟶ me gjak, se kanë ⟶ hormoni lirohet
⟶ endokrine ⟶ kapilarë gjaku ⟶ direkt në gjak

Mësuesi/ja shënon në dërrasë komentin e bërë për hormonin.
**Pjesa kryesore:**
Mësuesi/ja shpjegon: Në çastin e parë, sapo ju përmenda kontrollin e kapitullit, te secili prej jush u zgjua hormoni adrenalinë, i prodhuar nga dy gjëndrat mbiveshkore, sepse truri dërgon ngacmime dhe adrenalina sekretohet në gjak. Adrenalina bën gjithashtu që mëlçia të lëshojë glukozë në gjak. Ndërton një tabelë në dërrasë.

| **Gjëndra** | **Hormoni që ajo sekreton** | **Funksioni i hormonit** |
|---|---|---|
| Gjëndër mbiveshkore | Adrenalinë | Përgatitja e trupit për veprim të fuqishëm. |
| Pankreas | Insulinë | Zvogëlon përqindjen e glukozës në gjak. |
| Teste | Testosteron | Shkakton zhvillimin e karakteristikave seksuale dytësore te meshkujt. |
| Vezore | Estrogjen | Shkakton zhvillimin e karakteristikave seksuale dytësore te femrat dhe kontrollon ciklin menstrual. |

**Pjesa përfundimtare:**
Më pas, mësuesi/ja realizon një krahasim midis sistemit nervor dhe atij endokrin. Dy nxënës/e, nga informacioni që kanë marrë, plotësojnë krahasimin. Njëri prej tyre rendit karakteristikat e sistemit nervor. Tjetri rendit karakteristikat e sistemit endokrin.

| Sistemi nervor | Sistemi endokrin |
|---|---|
| Përbëhet nga neurone. | Përbëhet nga qeliza sekretuese. |
| Informacioni transmetohet në formë impulsesh elektrike. | Informacioni transmetohet në formë substancash kimike të quajtura hormone. |
| Impulset transmetohen përgjatë fibrave nervore (aksone dhe dentrite). | Substancat kimike transp ortohen të tretura në plazmën e gjakut. |
| Impulset udhëtojnë me shpejtësi. | Substancat udhëtojnë më ngadalë. |
| Efekti i një impulsi nerv or zgjat vetëm për një kohë të shkurtër. | Efekti i një hormoni mund të zgjasë më tepër. |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me ndërtimin e gjëndrave me sekrecion të brendshëm.
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et rreth njohurive që kanë për ndërtimin dhe lidhjet që kanë gjëndrat endokrine me hormonin që ato prodhojnë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyra 4, faqe 78, Biologjia 7.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Sistemet e organeve te njeriut | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan si gjëndrat endokrine kontrollojnë organe e funksionet të caktuara nëpërmjet hormoneve. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** III.5; I.4; II.6; II.7; III.7; III.8. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore: 1.37** Kontrolli i funksioneve të organeve nga gjëndrat endokrine | | | |
| **Fjalët kyçe:** adenohipofiza, neurohipofiza, lajmëtarë kimikë, hormon, *feed-back* negativ, insulina, glukagoni | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>-Përshkruan konceptet hormone dhe gjëndër endokrine;<br>-Rendit gjëndrat e rëndësishme endokrine;<br>-Shpjegon funksionin e gjëndrave endokrine dhe hormonet që sekretojnë këto gjëndra.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>-Emërto dy-tri nga gjëndrat endokrine në trupin e njeriut;<br>-Interpreto një funksion të një gjëndre me hormonin që ai sekreton dhe rolin e tij. | | | |
| **Burimet:** Libri i biologjisë së klasës 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja, lapsi, tabela të gjëndrave të ndryshme endokrine në trupin e njeriut. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, anatomi, TIK | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Pjesa hyrëse:** *Mësim i përqendruar në argumente*<br>Mësuesi/ja u tregon se hormonet janë mesengjerë (bartës të mesazheve) kimikë.<br>Hormonet funksionojnë së bashku me nervat. | | | |

Gjëndrat kryesore: hipotalami, hipofiza, gjëndra tiroide, gjëndra paratiroide, gjëndrat mbiveshkore, pankreasi.
Mësuesi/ja shënon në dërrasë komentin e bërë për gjëndrat.

**Pjesa kryesore:** Ditari dypjesësh
Mësuesi/ja shpjegon: pasta në tabelë paraqet ditarin dypjesësh të cilin e plotësojnë nxënësit/et pasi ta lexojnë njësinë mësimore.

| Gjëndrat | Hormonet |
|---|---|
| Adenohipofiza | |
| Neurohipofiza | |
| Gjëndra tiroide | |
| Gjëndra paratiroide | |
| Gjëndrat mbiveshkore | |
| Cipa e gjëndrave mbiveshkore | |
| Palca e gjëndrave mbiveshkore | |
| Pankreasi | |

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit/et zhvillon një diskutim rreth hormoneve dhe funksioneve të tyre.

**Pjesa përfundimtare:** Kllaster
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që njohuritë e fituara t'i vendosin në Kllaster.




**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me kontrollin e funksioneve të organeve nga gjëndrat endokrine.
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et rreth njohurive që kanë për lidhjet që kanë gjëndrat endokrine me hormonin që ato prodhojnë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyra 3, faqe 80, Biologjia 7.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Shumimi te njeriu | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan ndërtimin e qelizave mashkullore dhe femërore | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br>I.2; II.6; II.7; III.7; VI.1. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore: 2.1** Qelizat e riprodhimit te mashkulli dhe te femra | | | |
| **Fjalët kyçe:** Spermatozoid, qelizë, vezë, ovocite, folikul, ovulim | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>-Bën dallimin mes qelizës mashkullore dhe femërore.<br>-Tregon si ndërtohen qelizat mashkullore dhe femërore<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>-Shpjegon pse numri i spermatozoideve është më i madh sesa numri i vezëve. | | | |
| **Burimet:** Libri i biologjisë së klasës 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja, lapsi, video e ndërtimit të qelizave të riprodhimit. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, anatomi, TIK | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Pjesa hyrëse:** Stuhi mendimesh<br>Mësuesi/ja u tregon një video të ndërtimit të qelizave mashkullore dhe femërore, pastaj nxënësit/et i shprehin mendimet e tyre rreth njësisë mësimore. | | | |

**Pjesa kryesore:** D.R.T.A
Mësuesi/ja shpjegon: pasta në tabelë paraqet ditarin dypjesësh të cilin e plotësojnë nxënësit/et pasi ta lexojnë njësinë mësimore.

| Ndërtimi i qelizave mashkullore | Ndërtimi i qelizave femërore |
|---|---|
| | |

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit/et zhvillon një diskutim rreth qelizave mashkullore dhe femërore të ndërtimit, strukturës etj.

**Pjesa përfundimtare:** Teknika e pyetjeve
Mësuesi/ja bën kontrollimin e njohurive të nxënësve duke u bërë pyetje kurse nxënësit/et japin përgjigjet e tyre:
1.Si prodhohen gamete mashkullore dhe femërore?
2.Si është i ndërtuar spermatozoidi?
3.Kur fillojnë të prodhohen spermatozoidet?
4.Si është e ndërtuar qeliza vezë?
5.Ç'është ovulimi?

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me qelizat e riprodhimit te mashkulli dhe te femra.
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et rreth njohurive që kanë për ndërtimin e qelizave mashkullore dhe femërore.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyra 1-3, faqe 87, Biologjia 7.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Shumimi te njeriu | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Tregon se sistemi riprodhues seksual lehtëson procesin e trashëgimisë (bartjen e informatave gjenetike ose tipareve gjenetike nga një gjeneratë në tjetrën). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br>I.2; II.6; II.7; III.3,III.7; VI.1. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore: 2.2** Trashëgimia gjenetike në bazë të sistemit të riprodhimit seksual | | | |
| **Fjalët kyçe:** Gameta, fekondim, zigotë, kromozome, diferencim, qeliza burimore embrionale. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>**Nxënësi/ja:**<br>-Përshkruani procesin e fekondimit.<br>-Bën dallimin mes qelizave trupore dhe seksuale sa i përket numrit të kromozomeve.<br><br>**Kriteret e suksesit:**<br>-Shpjegon procesin e diferencimit.<br>-Tregon funksionin e qelizave burimore embrionale. | | | |
| **Burimet:** Libri i biologjisë së klasës 7<br>**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, fletorja, lapsi, video e procesit të fekondimit. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, Anatomi, TIK. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Pjesa hyrëse:** Parashikim me terma paraprakë<br>Mësuesi/ja përzgjedh disa nga fjalët kyçe të temës, të cilat i shënon në tabelë dhe u kërkon nxënësve që për 5-10 minuta të shkruajnë një paragraf ku do të përdorin këto fjalë.<br>Fjalët e zgjedhura janë: spermatozoidi, qeliza vezë, fekondimi, zigota, diferencim, qeliza diploid, aploide.<br>Nxënësit/et mbajnë shënime individuale pastaj i paraqesin para nxënësve në klasë. | | | |

**Pjesa kryesore:** Teknika e pyetjeve
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të lexojnë njësinë mësimore pastaj bën kontrollimin e njohurive të nxënësve, duke u bërë pyetje kurse nxënësit/et japin përgjigjet e tyre:

1. Ç'është fekondimi?
2. 2.Sa është numri i kromozomeve te njeriu?
3. 3.Cili është dallimi mes qelizave diploid dhe aploide?
4. Ç'është diferencimi?
5. Cili është funksioni i qelizave burimore embrionale?

**Pjesa përfundimtare:** Fjalëkryqe
Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit/et që njohuritë e fituara t'i paraqesin nëpërmjet fjalëkryqit.

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | F | E | K | O | N | D | I | M |
| | | | | R | | | | | |
| | | | | O | | | | | |
| | | | | M | | | | | |
| D | I | P | L | O | I | D | E | | |
| | | | | Z | | | | | |
| | | | | O | | | | | |
| | | | | M | | | | | |
| | G | A | M | E | T | E | | | |
| | | | | | | M | | | |
| | | | | | | B | | | |
| | | | | | | R | | | |
| | | | | | | I | | | |
| | | | | | | O | | | |
| | | | | | | N | | | |
| | | | | | | A | | | |
| | | | | | | L | | | |
| | | | | | | E | | | |
| | | | | | | | | | |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me procesin e riprodhimit.
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et rreth njohurive që kanë për sistemin e riprodhimit seksual.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyra hulumtoni në internet rreth procesit të frytnimit te llojet e ndryshme të organizmave.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** III | **Klasa:** VII |
| **Tema:** Shumimi te njeriu | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan shkurtimisht strukturat e sistemeve riprodhuese të individit femër dhe mashkull si dhe funksionin e tyre në frytëzim. | |
